

Kodet e Praktikave të ILO-s

**Regjistrimi dhe njoftimi i
aksidenteve në punë dhe sëmundjeve
profesionale**

Zyra Ndërkombëtare e Punës, Gjenevë

Parathënie

Instrumentat dhe kodet e mëparshëm të praktikave të Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ILO) kanë në përbërje dispozita të përgjithshme mbi raportimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Gjithsesi, ato janë marrë në një masë shumë të kufizuar me nevojën e harmonizimit dhe të regjistrimit e njoftimit më efektiv të aksidenteve dhe sëmundjeve të tilla, si një mjet për veprim parandalues. Mungesa e udhëzuesve të pranuar botërisht do të thotë që përcaktimet e vendeve të veçanta mbi aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, shpesh ndryshojnë nga përcaktimi standart ndërkombëtar, i rekomanduar nga rezoluta e statistikave të dëmtimeve në punë, miratuar nga Konferenca e 13-të Ndërkombëtare e Statisticjenëve të Punës (Gjenevë, 1982); ndryshime midis vendeve egzistojnë gjithashtu në procedurat e grumbullimit dhe njoftimit, si edhe në fushë-mbulimin dhe burimet e statistikave. Përfundimi është një shumëllojshmëri situatash në Shtetet anëtarë. Krahasimet e bëra në nivel ndërkombëtar lidhur me përmasat e suksesit të arritur në përputhjen, zbatueshmërinë dhe veprimin parandalues, janë të pamundëshme sa kohë që nuk është arritur harmonizimi i tyre.

Në përputhje me vendimin e marrë nga Organi Qeverisës i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) në Sesionin e 259-të të tij (Mars 1994), nga data 3 deri më 11 Tetor 1994 në Gjenevë u realizua një Mbledhje e ekspertëve për të hartuar një kod të praktikës lidhur me regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Mbledhja u ndoq nga 21 ekspertë, nga të cilët shtatë u emëruan pas konsultimeve me qeveritë, shtatë të tjerë pas konsultimeve me grupin e Punëdhënësve dhe shtatë të fundit u emëruan pas konsultimeve me grupin e Punëtorëve të Organit Qeverisës.

Ekspertët nënvizuan se grumbullimi, regjistrimi dhe njoftimi i të dhënave lidhur me aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, përbënin në vetvehte instrumenta parandalimi dhe se ishte gjithashtu e rëndësishme të identifikoheshin dhe të studioheshin shkaqet e aksidenteve dhe sëmundjeve të tilla, me synim zhvillimin e masave parandaluese. Në përputhje me këtë ata ndryshuan një projekt të përgatitur prej Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ILO) dhe miratuan kodin e praktikës, duke vënë në dukje që dispozitat e këtij të fundit duhet të konsideroheshin si kërkesat bazë për grumbullimin, regjistrimin dhe njoftimin e të dhënave të besueshme lidhur me aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, si edhe të statistikave të lidhura me to. Përveç kësaj, u bënë rekomandime lidhur me kërkesat e barazvlefshme për regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme.

Kodi i kushton një vend shumë më të dukshëm përdorimit efektiv të të dhënave të grumbulluara, regjistruara dhe njoftuara, si mjet për veprimin parandalues, se sa përpunimit të statistikave. Si i tillë ai shërben si instrument i dobishëm i autoriteteve kompetente në zhvillimin e sistemeve për regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Ai jep gjithashtu njohuri të vlefshme për një veprim të përbashkët nga ana e punëdhënësve dhe punëtorëve, si edhe për aktivitetet e organizuara nga ana e qeverive, institucioneve të sigurimeve shoqërore dhe organizatave të tjera, që synojnë parandalimin e përgjithshëm të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.

Lidhur me raportin midis udhëzimeve të përshkruara në Konventën e Përfitimeve për Dëmtimet në Punë, 1964 (Nr. 121), dhe atyre për regjistrimin dhe njoftimin e të

dhënave të statistikave të punësimit, ekspertët zgjedhën që në tekstin e kodit të lënë mënjane referencat ndaj sistemeve të veçuar dhe specifike. U shpreh mbështetje në favor të një sistemi, i cili arrin që të trajtojë të gjithë informacionin e mbledhur.

Raporti i mbledhjes tregon fare qartë fushat e ndryshme problematike të ndeshura gjatë shqyrtimeve dhe reflekton arsyet për formulimin përfundimtar të kodit. Një pjesë e raportit është riprodhuar këtu me qëllim që t'i japë përdoruesve të vet më shumë qartësi, si edhe njohuri shtesë.

Rekomandimet praktike të këtij kodi të praktikës janë përgatitur për përdorimin e të gjithë personave që kanë përgjegjësi për raportimin, regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Kodi nuk është një dokument ligjërishit i detyrueshëm dhe ai nuk synon të zëvendësojë ligjet nacionalë, rregullat apo standartet e pranuar. Dispozitat e tij konsiderohen si kërkesat bazë për regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, dhe nuk synojnë të dekurajojnë autoritetet kompetente për miratimin e standarteve më të larta. Kodi u hartua duke pasur si objekt dhënien e njohurive personave që mund të jenë të angazhuar në formulimin e dispozitave dhe në ngritjen e sistemeve, procedurave dhe udhëzimeve për regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme, si edhe hetimit dhe parandalimit të tyre. Ai është i një rëndësie të veçantë për autoritetet kompetente, autoritetet e tjera qeveritare dhe publike, si për shembull, për institucionet e sigurimeve shoqërore, drejtuesit, punëdhënësit dhe punëtorët, si edhe organizatat e tyre.

Rrethanat lokale si edhe qenia e burimeve financiare dhe teknike, do të përcaktojnë se deri në ç'masë është praktike ndjekja e dispozitave të këtij kodi. Më tej, këto dispozita duhet të lexohen në rrethanat e kushteve të shtetit që propozon përdorimin e informacionit. Duke e pasur këtë parasysh, janë marrë në konsideratë nevojat e vendeve në zhvillim dhe ato të vendeve që synojnë të vendosin ose të modifikojnë sistemet e tyre të regjistrimit dhe njoftimit të aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme.

Teksti i kodit u aprovua për publikim nga ana e Organit Qeverisës të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) në Sesionin e saj të 261-të (Nëntor 1994).

Pasqyra e lëndës

Parathënie

Pjesë nga raporti i Mbledhjes së Ekspertëve mbi Regjistrimin dhe Njoftimin e Aksidenteve në Punë dhe Sëmundjeve Profesionale (Gjenevë, 3-11 Tetor 1994)

1. Dispozitat e përgjithshme

- 1.1. Objektivat
- 1.2. Hapësira vepruese
- 1.3. Përkufizimet

2. Politika në fushën e regjistrimit, njoftimit dhe hetimit të aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe ngjarjeve të rrezikshme, dhe statistikat përkatëse

- 2.1. Politika dhe parimet në nivelin kombëtar
- 2.2. Politika dhe parimet në nivelin e ndërmarrjes

3. Udhëzimet ligjore, institucionale dhe administrative për ngritjen e sistemeve të raportimit, regjistrimit dhe njoftimit

- 3.1. Të përgjithshmet
- 3.2. Klasifikimi i informacionit që duhet të regjistrohet dhe njoftohet

4. Raportimi në nivelin e ndërmarrjes

5. Udhëzimet për regjistrimin

- 5.1. Në nivelin kombëtar
- 5.2. Në nivelin e ndërmarrjes

6. Udhëzimet për njoftimin

- 6.1. Në nivelin kombëtar
- 6.2. Në nivelin e ndërmarrjes
- 6.3. Njoftimi i aksidenteve në punë
- 6.4. Njoftimi i sëmundjeve profesionale
- 6.5. Njoftimi i ngjarjeve të rrezikshme

7. Shtirja e sistemeve të regjistrimit dhe njoftimit tek personat e vet-punësuar

- 7.1. Në nivelin kombëtar
- 7.2. Në nivelin e ndërmarrjes
- 7.3. Personi i vet-punësuar

8. Statistikat e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes dhe ngjarjeve të rrezikshme: përpilimi dhe publikimi

- 8.1. Në nivelin kombëtar
- 8.2. Regjistrimi dhe njoftimi në mënyrë progresive i informacionit më të detajuar

9. Statistikat e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe ngjarjeve të rrezikshme: klasifikimet

- 9.1. Të përgjithshmet
- 9.2. Aksidentet në punë
- 9.3. Sëmundjet profesionale
- 9.4. Ngjarjet e rrezikshme

10. Hetimi i aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme

- 10.1. Në nivelin kombëtar
- 10.2. Në nivelin e ndërmarrjes
- 10.3. Punëtorët dhe hetimi i aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme

Literatura

Konventat dhe Rekomandimet ndërkombëtare përkatëse të punës

Shtojcat

- Shtojca A: Katalogu i I-rë: Lista e sëmundjeve profesionale (ndryshuar më 1980)
- Shtojca B: Lista e propozuar e sëmundjeve profesionale
- Shtojca C: Klasifikimi Ndërkombëtar Industrial Standart i të gjithë Aktiviteteve Ekonomike (rishikimi i tretë)
- Shtojca D: Klasifikimi Ndërkombëtar Standart i Profesioneve (ISCO-88), grupet parësorë, parësorë të shkallës së dytë dhe dytësorë
- Shtojca E: Klasifikimi Ndërkombëtar i Statusit në Punësim (ICSE)
- Shtojca F: Klasifikimi i aksidenteve industriale sipas natyrës së dëmtimit
- Shtojca G: Klasifikimi i aksidenteve industriale sipas vendndodhjes trupore të dëmtimit
- Shtojca H: Klasifikimi i aksidenteve industriale sipas tipit të aksidentit
- Shtojca I: Klasifikimi i aksidenteve industriale sipas mjetit

Pjesë nga raporti i Mbledhjes së Ekspertëve mbi Regjistrimin dhe Njoftimin e Aksidenteve në Punë dhe Sëmundjeve Profesionale (Gjenevë, 3-11 Tetor 1994)

Shqyrtimi i projekt-kodit të praktikës

...

10. Gjatë diskutimit të përgjithshëm, ekspertët ishin në një mendje se dokumenti i përgatitur nga Zyra Ndërkombëtare e Punës (ILO) ofronte një bazë të përshtatshme për diskutim në Mbledhje. Ekspertët mbështetën pikpamjen se grumbullimi, regjistrimi dhe njoftimi i të dhënave lidhur me aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, përbënin instrumenta për parandalimin e tyre. Gjatë analizës së aksidenteve në punë, ngarkimi i përgjegjesisë për aksidentin nuk duhet të përbëjë shqetësimin kryesor. Ishte e rëndësishme të studioheshin shkaqet e aksidenteve me synim zhvillimin e masave parandaluese. Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme në kushtet e kostos së lartë të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale. U theksua gjithashtu që përfundimet e Mbledhjes do të merreshin në konsideratë nga Konferenca e 16-të Ndërkombëtare e Stacioneve të Punës, e cila është planifikuar paraprakisht të zhvillohet në vitin 1998.

11. Ekspertët vunë në dukje se, ndërsa kodi duhet të shërbente si një instrument i dobishëm për autoritetet kompetente në zhvillimin e sistemeve të regjistrimit dhe njoftimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, ai duhet gjithashtu të jepte njohuri të vlefshme për një veprim të përbashkët nga ana e punëdhënësve dhe punëtorëve, i cili synonte parandalimin e përgjithshëm të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Në procesin e grumbullimit të të dhënave, duhet që të përfitohej edhe prej statistikave të përpiluara nga ana e institucioneve të sigurimeve shoqërore. Gjithsesi, duhet bërë dallim midis akspekteve ligjore që shkaktuan kompensimin, dhe aspekteve analitike, me synim shmangien e problemeve që lidhen me raportimin e dyfishtë. Disa ekspertë bënë gjithashtu të ditur se egzistonte një problem i përgjithshëm i nën-raportimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Vëmendje e duhur duhet t'i jepej gjithashtu aspektit të shkallës së prekshmërisë së aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, për arsye të mësimave që mund të nxirreshin prej tyre.

12. Disa ekspertë theksuan se, megjithëse ishte e rëndësishme që kodi të plotësohej me shtojcat e përmendura në dokument, regjistrimi dhe njoftimi i sëmundjeve profesionale nuk duhej të kufizohej vetëm tek ato që shihen në listën e sëmundjeve profesionale (ndryshuar më 1980) të Konventës së Përfitimeve nga Dëmtimet në Punë, 1964 (Nr. 121). Duhet të kuptohet që sëmundjet e reja profesionale kishin gjasa të shfaqeshin në rastet e atyre sëmundjeve, të cilat kanë një periudhë të gjatë inkubacioni, duke ndjekur ekspozimin e punëtorëve ndaj rreziqeve të procesit të punës.

13. Gjatë diskutimit të objektivave të kodit, ekspertët theksuan nevojën për t'i dhënë një vend më të dukshëm parandalimit, se sa elementit të statistikave. Ata ranë dakort të kërkojnë qëndrueshmëri gjatë përpilimit të statistikave në nivel kombëtar, me synim përmirsimin e krahasueshmërisë ndërkombëtare, dhe të mbajnë në konsideratë

aksidentet gjatë lëvizjes në promovimin e zhvillimit progresiv të procedurave dhe metodave të regjistrimit dhe njoftimit. Aksidentet gjatë lëvizjes shkaktojnë humbje të mëdha ekonomike të ndërmarrjes dhe për këtë meritojnë vëmendje. Ekspertët ranë dakort që të zgjerohet fushë-mbulimin e kodit nëpërmjet shtimit të një teksti, i cili do të trajtonte rritjen e ndërgjegjësimit midis ofruesve të shërbimit të kujdesit shëndetsor, për efektet e mundshme të punës së një personi mbi shëndetin e pacientëve të tij. Ata gjykuan që nuk kishte nevojë të zgjerohet fushë-mbulimi për të përfshirë objekte të tillë, si për shembull monitorimin mjedisor të ekspozimit të punëtorëve ndaj substancave të transportuara nëpërmjet ajrit, meqenëse kjo ishte mbuluar ashtu siç duhej nga kode të tjerë të praktikës të Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ILO) dhe për arësyen se objekti i ekspozimit mjedisor ishte jashtë hapësirës vepruese të një kodi të praktikës mbi regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.

14. Më tej është vënë në dukje roli i institucioneve të sigurimeve shoqërore në fushën e parandalimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Puna në këtë fushë synon gjithashtu të inkurajojë qeveritë që të harmonizojnë sistemet e statistikave dhe përcaktimet për aksidentet të ndodhur jashtë vendit të punës, si për shembull, aksidentet e trafikut, ato të ndodhur në shtëpi apo gjatë kohës së lirë, duke kërkuar që të krijojnë kushtet për një përdorim të përmirësuar të të dhënave statistikore për qëllime parandalimi; kjo ka qënë veçanërisht e dobishme në parandalimin e aksidenteve gjatë lëvizjes, të cilët nuk ishin nën kontrollin e punëdhënësit.

15. Në vazhdim të një diskutimi të gjërë mbi listën e përcaktimeve të dhëna në kod, ekspertët ranë në një mëndje, në disa raste, t'i përmbaheshin tekstit të përdorur tek instrumentat e mëparshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ILO), me qëllim që të ruhej vazhdimësia. U arrit në përfundimin se përcaktimet e termave të tjerë duhet të bëheshin, aq sa kjo do të ishte e arsyeshme, të krahasueshëm me gjuhën që rezultonte në disa legjislacione kombëtarë, si një përpjekje për t'i dhënë një shtysë harmonisë në grumbullimin e të dhënave lidhur me regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme. Në këtë vështrim, ekspertët e gjetën të nevojshme të inkurajojnë autoritetet kompetente që, gjatë hartimit të koncepteve dhe terminologjive të tyre lidhur me regjistrimin dhe njoftimin e të dhënave të punësimit, të jenë konsekuente me përcaktimet e këtij kodi, por edhe të instrumentave të tjerë ndërkombëtarë, me qëllim që të arrihet harmonizimi. Ekspertët ranë dakort gjithashtu që të fshijnë referencën në këtë kod ndaj përcaktimeve të disa termave, veçanërisht në rastet kur ato ishin të përpunuara mjaftueshëm në pjesën kryesore të dokumentit. Në vazhdim të një diskutimi të gjërë lidhur me termin "përfaqsesi i punëtorëve" dhe të një përpjekje të një grupi pune për të formuluar një përcaktim të ri, Mbledhja vendosi të citojë Konventën e Përfaqsesve të Punëtorëve, 1971 (Nr. 135). Në përgjigje të pyetjeve të disa ekspertëve lidhur me fushë-mbulimin e termit "kombëtar", të përdorur nëpër kod, Këshilltari Ligjor i bëri të ditur Mbledhjes që termi mbulonte sistemet shtetërorë dhe federalë.

16. Gjatë diskutimit të politikës së regjistrimit, njoftimit dhe hetimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, ekspertët përkrahën një numër dispozitash, të cilat e përshtatën më tej tekstin tashmë të përdorur në Konventën e

Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, 1981 (Nr. 155), si edhe në Konventën e Shërbimeve të Shëndetit në Punë, 1985 (Nr. 161). Ata ranë në një mendje për atë që vendosja dhe zbatimi i sistemit kombëtar për regjistrimin, njoftimin dhe hetimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme, do të ishte detyrë e autoritetit kompetent. Ata vendosën gjithashtu që organet tri-palëshe dhe organizatat e tjera të përfshira në këtë proces, të kishin një rol të rëndësishëm në nxitjen e bashkëveprimit dhe zbatimit të politikave kombëtare në këtë fushë. Për pasojë, nevoja që punëdhënësit, punëtorët dhe organizatat e tyre të punojnë së bashku, u riafirmua. Mbledhja tërhoqi vëmendjen tek kontributi i regjistrimit, njoftimit dhe hetimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, në nxitjen e parandalimit të ngjarjeve.

17. Ekspertët ranë gjithashtu dakort për atë që zbatimi i sistemit kombëtar, i përmendur në paragrafin 16 (më sipër), duhet të realizohet nga punëdhënësi në konsultim me punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre. Më tej u vendos që në çdo rast kur dy ose më shumë punëdhënës ndërmarrin njëherësh aktivitete në të njëjtin shesh pune, ata duhet të bashkëpunojnë në zbatimin e politikës kombëtare, dhe që mekanizmi për një bashkëpunim të tillë duhet të përgatitet nga autoriteti kompetent.

18. Gjatë diskutimit të përgjithshëm lidhur me udhëzimet ligjore, institucionale dhe administrative për ngritjen e sistemeve të raportimit, regjistrimit dhe njoftimit, u ra dakort që konceptet dhe terminologjia përkatëse të përcaktohen nga autoriteti kompetent, në konsultim me organizatat më të përfaqsuara të punëdhënësve dhe punëtorëve. Pati gjithashtu një konsensus të përgjithshëm në atë që konceptet dhe terminologjia duhet të jenë në përputhje me këtë kod, si edhe me marrëveshjet dhe rekomandimet ndërkombëtare.

19. Mbledhja e pranoi vlerën dhe nevojën për udhëzues sipas listave të sëmundjeve profesionale, veçanërisht në vendet që ishin në faza të ndryshme zhvillimi, ku këto lista nuk egzistonin fare. Sidoqoftë, ekspertët pranuan vështirësitë që qëndrojnë në natyrën e njohjes së sëmundjeve profesionale. Si përfundim, Mbledhja rekomandoi që Shtojca A e titulluar “Katalogu I: Lista e sëmundjeve profesionale (ndryshuar më 1980) tek Konventa e Përfitimeve të Dëmtimit në Punë, 1964 (Nr. 121)”, të rifreskohej si material, ndërsa lista e sëmundjeve profesionale e riprodhuar në Shtojcën B, siç qe propozuar nga Konsultimi Jozyrtar mbi Rishikimin e Listës së Sëmundjeve Profesionale, i bashkangjitur Konventës së Përfitimeve nga Dëmtimet në Punë, 1964 (Nr. 121), të organizuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) më 1991, të përdorej si një model për një listë më të gjatë. Mbledhja ishte gjithashtu e mendimit se autoriteti kompetent duhet të jetë përgjegjës për klasifikimin e informacionit, për të cilin ka marrë njoftim, dhe për zhvillimin e një klasifikimi të tillë, me synim dhënien e ndihmës në vendosjen e një lidhje shkakësore midis sëmundjeve profesionale dhe shkaqeve të tyre.

20. Lidhur me raportet midis udhëzimeve të përshkruara në Konventën e Përfitimeve nga Dëmtimet në Punë, 1964 (Nr. 121), dhe atyre për regjistrimin dhe njoftimin e statistikave të punësimit, Mbledhja zgjodhi që të lerë jashtë tekstit të kodit referencat ndaj sistemeve të vetmuara dhe specifike. Shqetësimi i lidhur me këtë çështje

duhet të shprehet në parathënien e kodit, ku mbështetja duhet të jepet në favor të një sistemi i cili e trajton të gjithë informacionin. Parathënia duhet të nxjerrë po ashtu në pah rolin e institucioneve të sigurimeve shoqërore në fushën e parandalimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.

21. Gjatë diskutimit të raportimit në nivel ndërmarrje, u vu theks si mbi përgjegjësinë e punëdhënësit për të ndërtuar udhëzimet e nevojshme për raportimin, po ashtu edhe mbi detyrimin e punëtorëve për të raportuar. Në të njëjtën masë u vu theks edhe mbi nevojën për ruajtjen e të drejtave të punëtorëve lidhur me fshehtësinë e të dhënave të tyre mjekësore dhe personale, në zotërim të punëdhënësve, siç përshkruhet në Rekomandimin e Shërbimeve të Shëndetit në Punë, 1985 (Nr. 171).

22. Ekspertët pranuan që ishte e vështirë të ndërtoje një formular të përbashkët për të gjithë aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale. Sidoqoftë, u vu në dukje që standartizimi i formularëve mund të përdorej në rastin kur kategoritë e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale do të ishin të njëjta. Ligjet dhe rregullat kombëtare duhet të specifikojnë gjithashtu përmbajtjen dhe formatin e regjistrimeve në nivelin e ndërmarrjes, periudhën e kohës gjatë së cilës duhet të bëhet raportimi, si edhe kohëzgjatjen e mbajtjes së regjistrimeve në një mënyrë që u lejon atyre ri-përdorimin. U bë i ditur gjithashtu pranimi i raporteve të punëdhënësve mbi sigurimin e kompensimit, dhe i raporteve të aksidenteve, si regjistrime që mund të jenë të dobishme për njoftim.

23. Ekspertët ranë dakort që të përfshijnë në kod dy nivele për grumbullimin e të dhënave lidhur me njoftimin e aksidenteve në punë. Niveli i parë u hartua për të mbledhur informacionin minimal të kërkuar dhe u konsiderua i dobishëm për vendet me sisteme jo shumë të zhvilluar regjistrimi dhe njoftimi, ndërsa niveli i dytë përmbante informacionin shtesë. Në të dy nivelet, informacioni mbi numrin e punëtorëve, si tregues i madhësisë së ndërmarrjes, u trajtua si shumë i rëndësishëm, meqënëse ky ndihmonte gjatë procesit të hartimit të prirjeve në çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë, të cilat ishin karakteristike për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

24. Pati një konsensus të përgjithshëm për heqjen nga Kapitulli 6 të seksionit mbi hetimin për veprim parandalues, qëkurse pyetjet e pyetsorit dukej se kishin tendenca inkriminuese dhe, si të tilla, do të dekurajonin të intervistuarit në dhënien e informacionit. Kjo do të çonte për pasojë në fenomenin e nën-raportimit. Për të njëjtën arsye, pyetjet që kishin natyrë inkriminuese, u hoqën edhe nga seksionet e tjerë.

25. Ekspertët vunë në dukje se ishte përgjegjësi e personit që kontrollonte ndërmarrjen, ku ishte kontraktuar për të punuar një i vet-punësuar, që të bënte udhëzimet e nevojshme në nivelin e ndërmarrjes për raportimin, regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme. U vu në dukje gjithashtu fakti që personi i vet-punësuar duhet të ishte përgjegjës për bërjen e udhëzimeve të përshtatëshme për njoftim në ndërmarrjen e tij.

26. Duke diskutuar plotësimin dhe publikimin e statistikave, ekspertët ranë dakort të përcaktonin vitin kalendarik si periudhën-njësi të mbuluar nga statistikat, me synim nxitjen e harmonizimit të tyre midis vendeve të ndryshme. Ndërsa ekspertët e njohën faktin që referimi ndaj shpeshëtisë, shkallës së veprimit dhe normave të rrepta në projekt-kod mund të jepte një madhësi të kohës së humbur si pasojë e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, ata ranë dakort që të mos kërkojnë informacion lidhur me kostot e tyre të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, meqënëse dokumenti nuk e parashikonte mekanizmin e duhur për përpilimin e të dhënave të nevojshme.

27. Mbledhja vendosi që të përfshijë termat “aksident gjatë lëvizjes” dhe “incident” në titullin që merret me hetimin, me synim që të reflektojë hapësirën vepruese të kapitullit mbi këtë çështje. Duke diskutuar udhëzimet për hetimet që duhet të realizohen nga ana e inspektoriateve të punës ose nga agjensi të tjera të autorizuara, ekspertët ranë gjithashtu dakort që përfaqësuesit e punëdhënësve dhe të punëtorëve duhet të kenë mundësinë që të shoqërojnë personat hetues me kusht që, në opinionin e personit hetues, një udhëzim i tillë nuk është i dëmshëm për hetimin. Në mënyrë të ngjajshme u ra dakort që, atje ku hetimi i besohet organeve që janë të ndryshme nga inspektoriatet e punës apo agjensitë e autorizuara, udhëzimet duhet të lejojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të punëdhënësve dhe të punëtorëve të prekur nga ky hetim.

28. Pati një konsensus të përgjithshëm për atë që, gjatë kryerjes së hetimeve të tyre, punëdhënësit duhet të raportojnë mbi masat e nevojshme të identifikuarra për parandalimin e përsëritjes së aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Mbledhja mbrojti gjithashtu tezën se përfaqësuesit e punëtorëve duhet të kenë të drejtën, mjetet dhe kohën e nevojshme, pa humbur të drejtën e pagesës, për të marrë pjesë në të tilla hetime.

1. Dispozitat e përgjithshme

1.1. Objektivat

1.1.1. Objektivat e këtij kodi janë:

- (a) rritja e hapësirës vepruese dhe efektivitetit të hetimit për shkaqet e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, si edhe të identifikimit dhe zbatimit të masave parandaluese;
- (b) vendosja e parimeve të përgjithshme dhe përforcimi e kanalizimi i aktiviteteve të ndryshme kombëtare, brenda sistemeve të qëndrueshëm kombëtarë të grumbullimit të informacionit të besueshëm mbi aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, me synim nxitjen e krahasueshmërisë ndërkombëtare;
- (c) dhënia e njohurive drejtuese gjatë hartimit të kornizave ligjore, administrative dhe praktike për regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;
- (d) nxitja e paraqitjes, monitorimit dhe vlefshmërisë së procedurave dhe metodave të njesuara për regjistrimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale dhe njoftimin e tyre tek autoritetet kompetente;
- (e) përmirësimi i kuptueshmërisë, krahasueshmërisë dhe analizës së statistikave mbi aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;
- (f) nxitja e zhvillimit progresiv të procedurave dhe metodave të regjistrimit dhe njoftimit të aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme;
- (g) rritja e ndërgjegjësimit midis atyre që ofrojnë kujdes shëndetsor, lidhur me efektet e mundshëm të punës që ata kryejnë ndaj shëndetit të pacientëve të tyre, me synim asistimin e autoriteteve kompetente në plotësimin e një informacioni më të plotë lidhur me dëmtimet dhe sëmundjet në punë.

1.1.2. Përveç kësaj, u bënë rekomandime lidhur me kërkesat e njëjta për regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve gjatë lëvizjes, të ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme.

1.2. Hapësira vepruese

1.2.1. Dispozitat e këtij kodi zbatohen në të gjithë degët e aktivitetit ekonomik, tek të gjithë ndërmarrjet dhe punëtorët, pavarësisht statusit të tyre të punësimit.

1.2.2. Dispozitat e këtij kodi duhet të konsiderohen si rekomandime bazë për regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme. Rregullat më rigorozë kombëtare dhe ndërkombëtare, kanë prioritet ndaj këtyre rekomandimeve.

1.2.3. Në këtë kod, njoftimi i autoriteteve kompetente përfshin të gjithë aksidentet në punë që sjellin vdekjen, ato që shkaktojnë humbjen e kohës së punës dhe të gjithë sëmundjet profesionale të përfshira në listën kombëtare apo të mbuluara nga përkufizimi i paracaktuar i sëmundjeve të tilla.

1.2.4. Në këtë kod, regjistrimi në nivelin e ndërmarrjes përfshin gjithashtu aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale që nuk janë të mbuluara nga kërkesat për njoftim të parashikuara në paragrafin 1.2.3 (më sipër), dhe në veçanti aksidentet gjatë lëvizjes dhe incidentet që nuk shkaktojnë humbje të kohës së punës.

1.3. Përkufizimet

1.3.1. Në këtë kod, termat në vazhdim kanë kuptimet që u janë dhënë bashkangjitur:

Aksidenti gjatë lëvizjes: Aksidenti që ndodh në rrugën e drejtpërdrejtë midis vendit të punës dhe

- (a) banesës kryesore ose të dytë të punëtorit;
- (b) vendit ku punëtori zakonisht konsumon vaktet e tij të ushqimit; ose
- (c) vendit ku punëtori merr zakonisht pagën e tij,

aksident, i cili përfundon me vdekjen ose me një dëmtim personal, duke shkaktuar uljen e kohës së punës. Aksidentet e trafikut, në të cilët punëtorët përfshihen gjatë orëve të punës dhe që ndodhin gjatë punës së paguar, konsiderohen si aksidente në punë.

Autoriteti kompetent: Një ministër, departament qeveritar ose autoritet tjetër publik, i cili ka pushtetin e lëshimit të rregullave, urdhëresave ose instruksioneve të tjera, që kanë forcën e ligjit. Sipas ligjeve apo rregullave kombëtare, autoritetet kompetente mund të emërohen duke pasur përgjegjësi për aktivitete të veçanta, si për shëmbull për zbatimin e politikës kombëtare dhe procedurave për raportimin, regjistrimin dhe njoftimin, kompensimin e punëtorëve dhe përpunimin e statistikave.

Personi kompetent: Personi me trajnim të përshtatshëm dhe dije të mjafta, me eksperiencë dhe zotësi për të kryer një punë të veçantë, në kushte të mira sigurie. Autoriteti kompetent mund të përcaktojë kriterin përkatës për caktimin e të tillë personave dhe mund të vendosë detyrat që duhet t'u jepen atyre.

Ngjarja e rrezikshme: Ngjarja që identifikohet lehtë, siç është përcaktuar në ligjet dhe rregullat kombëtare, me forcën për të shkaktuar një dëmtim ose sëmundje tek personat që punojnë, ose tek publiku.

Punëdhënësi: Personi fizik ose ligjor i cili punëson një ose më shumë punëtorë.

*Ndërmarrja:*¹ Njësia institucionale, ose kombinimi më i vogël i njësive institucionale, që përfshin dhe kontrollon drejtpërdrejtë ose tërthor të gjithë funksionet e nevojshme për të kryer aktivitetet e veta prodhuese.

*Ndërmarrja:*¹ Ndërmarrja (ose pjesa e ndërmarrjes), e cila në mënyrë të pavarur angazhohet në një (ose në pjesën më të madhe vetëm në një) lloj aktiviteti ekonomik në një vendndodhje, ose brenda një zone gjeografike, për të cilën të dhënat janë të disponueshme, ose që mund të plotësohen në mënyrë të qartë dhe të saktë, duke lejuar kështu llogaritjen e tepricës operative.

Dëmtimi fatal në punë: Dëmtimi në punë që çon në vdekje.

Paaftësia për punë: Paaftësia për të realizuar detyrat normale të punës.

Incidenti: Ngjarja që ndodh gjatë punës ose që është pasojë e saj, ku nuk shkaktohet ndonjë dëmtim personal, ose ku dëmtimi personal kërkon vetëm një trajtim të tipit të “ndihmës së parë”.

Dëmtimi ndaj shëndetit: Shih *Dëmtimi në punë*.

Humbja e kohës së punës: Ditët e humbura të llogaritura duke filluar që nga dita pasuese (përfshirë edhe këtë) e ditës së aksidentit, matur me ditë kalendarike, ditë jave, turne pune ose ditë pune. Ditët kalendarike janë të preferueshme si masë e llogaritjes së ashpërsisë të aksidentit, ndërsa ditët e punës preferohen si masë e llogaritjes së pasojës së tij ekonomike. Kur përdoren ditët e punës ose ditët e javës, atëherë duhet të jepet edhe një vlerësim sipas ditëve kalendarike, kur kjo është e mundur.

Koha e humbur: Shih *Humbja e kohës së punës*.

Dëmtimi jo vdekje prurës në punë: Dëmtimet në punë që nuk të çojnë në vdekje.

Njoftimi: Procedura e specifikuar në ligjet dhe rregullat kombëtare, që vendos rrugët nëpërmjet të cilave:

- (a) punëdhënësi ose personi i vet-punësuar dorëzon informacionin lidhur me aksidentet në punë, aksidentet gjatë lëvizjes, ngjarjet ose incidentet e rrezikshme; ose

¹ Për detaje të plota shih: Kombet e Bashkuara, Klasifikimi Ndërkombëtar Standart Industrial i të Gjithë Aktiviteteve Ekonomike, Revistat Statistike, Seritë M, Nr. 4, Rev. 3 (Nju York, 1990). Shih Shtojcën C të këtij kodi.

¹ Ibid

- (b) punëdhënësi, personi i vet-punësuar, institucioni i sigurimit dhe të tjerët që lidhen drejtpërdrejtë me çështjen, dorëzojnë informacionin lidhur me sëmundjet profesionale, sipas përshtatshmërisë dhe siç përshkruhet nga autoriteti kompetent.

Aksidenti në punë: Ngjarja që ndodh gjatë procesit të punës ose që është pasojë e tij dhe që rezulton në:

- (a) dëmtimin vdekje prurës në punë;
- (b) dëmtimin jo vdekje prurës në punë.

Sëmundja profesionale: Sëmundja që vjen si rezultat i ekspozimit ndaj faktorëve të rrezikshëm, që janë pasojë e aktivitetit të punës.

Dëmtimi në punë: Vdekja, çdo dëmtim ose sëmundje personale që rrjedh nga aksidenti në punë.

Regjistrimi: Procedura e specifikuar në ligjet dhe rregullat kombëtare, që vendos mbi mjetet me anë të të cilave punëdhënësi ose personi i vet-punësuar jep siguri që do të mbahet informacion lidhur me:

- (a) aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;
- (b) aksidentet gjatë lëvizjes, dhe
- (c) ngjarjet dhe incidentet e rrezikshme.

Raportimi: Procedura e specifikuar nga ana e punëdhënësit në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare, si edhe me praktikën në ndërmarrje, për dorëzimin nga ana e punëtorëve tek eprori i tyre i drejtpërdrejtë, tek personi kompetent apo tek çdo person apo organ tjetër specifik, të informacionit që lidhet me:

- (a) çfarëdo aksidenti në punë ose dëmtimi të shëndetit, i cili ndodh gjatë punës ose lidhet me të;
- (b) rastet e dyshuara të sëmundjeve profesionale;
- (c) aksidentet gjatë lëvizjes; dhe
- (d) ngjarjet dhe incidentet e rrezikshme.

Personi i vet-punësuar: Siç mund të përcaktohet nga ana e autoritetit kompetent, duke ju referuar versionit më të fundit të Klasifikimit Ndërkombëtar të Statusit në Punësim (ICSE).¹

Punëtori: Personi që kryen punë për punëdhënësin, rregullisht apo përkohësisht.

Përfaqësuesi i punëtorëve: Personi që njihet si i tillë nga ligji ose praktika kombëtare, në përputhje me Konventën e Përfaqësuesve të Punëtorëve, 1971 (Nr. 135).

¹ Shih Shtojcën E të këtij kodi.

2. Politika në fushën e regjistrimit, njoftimit dhe hetimit të aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe ngjarjeve të rrezikshme, dhe statistikat përkatëse.

2.1. Politika dhe parimet në nivelin kombëtar

2.1.1. Çdo qeveri duhet të emërojë një ose disa autoritete kompetente, si të jetë e përshtatshme, të cilët në përputhje me kushtet dhe praktikën kombëtare dhe në konsultim me organizatat më përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve, duhet të formulojnë, zbatojnë dhe rishikojnë periodikisht politikën kombëtare koherente (që këtej e tutje asaj do t'i referohemi si "politika") si edhe parimet mbi:

- (a) regjistrimin, njoftimin dhe hetimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;
- (b) regjistrimin, njoftimin dhe hetimin e aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme; dhe
- (c) përpilimin, analizën dhe publikimin e statistikave për të tilla aksidente, sëmundje dhe ngjarje.

2.1.2. Politika kombëtare duhet:

- (a) të synojë në parandalimin e aksidenteve dhe dëmtimeve të shëndetit që ndodhin gjatë procesit të punës, që lindin prej tij apo janë të lidhur me të, nëpërmjet përcaktimit dhe zvogëlimit të shkaqeve të aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme në mjedisin e punës;
- (b) të inicijojë aktivitete të përshtatshme kombëtare;
- (c) të fuqizojë aktivitetet e ndryshme kombëtare dhe t'i kanalizojë ato në një sistem të qëndrueshëm të grumbullimit të informacionit të besueshëm mbi aksidentet në punë, sëmundjet profesionale, aksidentet gjatë lëvizjes, ngjarjet dhe incidentet e rrezikshme;
- (d) të vendosë parime të përgjithshme dhe procedura të njesuara lidhur me raportimin, regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme, dhe t'i zbatojë ato në të gjitha degët e aktivitetit ekonomik dhe në të gjithë ndërmarrjet;
- (e) të thjeshtëzojë përgatitjen e statistikave vjetore lidhur me aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, si edhe të atyre të lidhura me aksidentet gjatë lëvizjes, ngjarjet dhe incidentet e rrezikshme, sipas përkatësisë;
- (f) të thjeshtëzojë analizat krahasuese.

2.1.3. Me qëllim sigurimin e koherencës të politikës dhe masave për zbatimin e saj, autoriteti kompetent duhet:

- (a) të vendosë funksionet dhe përgjegjësitë respektive të autoriteteve publike të përfshira në këtë proces, të punëdhënësve, punëtorëve dhe organizatave të tyre, si edhe të tjerëve, duke marrë në konsideratë karakterin plotësues të detyrimeve dhe përgjegjësisë të tilla, si edhe të kushteve e praktikës kombëtare;
- (b) t'i bëjë udhëzimet të përshtatshme ndaj kushteve dhe praktikës kombëtare, për të siguruar bashkërendimin e nevojshëm midis autoriteteve dhe organeve të ndryshme, që do të zbatojnë politikën.

2.1.4. Autoriteti kompetent duhet të krijojë dhe zbatojë në mënyrë progresive një sistem kombëtar për regjistrimin, njoftimin dhe hetimin e aksidenteve në punë, të sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikëshme për të gjitha degët e aktivitetit ekonomik dhe gjithë ndërmarrjet, si edhe për të gjithë punëtorët, pavarësisht statusit të tyre të punësimit.

2.1.5. Dispozitat e hartuara duhet të jenë të mjaftueshme dhe të përshtatshme në raport me tipin specifik të ndërmarrjes dhe statusin në punësim të punëtorëve.

2.1.6. Në rast se një sistem i tillë kombëtar nuk mund të zbatohet menjëherë për të gjithë ndërmarrjet dhe tipet e statusit në punësim të punëtorëve, autoriteti kompetent duhet të hartojë plane për zgjerimin e tij progresiv, në konsultim me organizatat më përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve.

2.1.7. Sa herë që rrethanat e kërkojnë dhe kushtet dhe praktika kombëtare e lejon, bashkërendimi dhe zbatimi i politikës duhet të nxitet prej një organi të përbërë nga organizatat më përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve, si edhe nga organizatat dhe autoritetet e tjerë të përfshirë në këtë çështje, ashtu siç specifikohet nga ligjet dhe rregullat kombëtare, ose nga autoriteti kompetent.

2.1.8. Autoriteti kompetent duhet të bëjë të mundur zbatimin e ligjeve dhe rregullave kombëtare lidhur me politikën, nëpërmjet një sistemi të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm inspektimi.

2.1.9. Sistemi i zbatimit të ligjeve duhet të parashikojë gjoha të mjaftueshme për shkeljet e ligjeve dhe rregullave kombëtare që lidhen me politikën.

2.1.10. Situata që ka të bëjë me politikën dhe zbatimin e saj, duhet të rishikohet nga ana e autoritetit kompetent në intervale të përshtatshme, në tërësi, ose lidhur me pjesë të veçanta, me qëllim identifikimin e problemeve më të mëdha, zhvillimin e metodave efektive për t'u marrë me to, vendosjen e prioriteteve për veprim, si edhe për vlerësimin e rezultateve.

2.1.11. Autoriteti kompetent duhet të bëjë të mundur dhënien e njohurive punëdhënësve dhe punëtorëve, për t'i ndihmuar këta që ta përputhin aktivitetin e tyre me detyrimet ligjore që rrjedhin nga kjo politikë.

2.1.12. Në rastet e përshtatshme, autoriteti kompetent duhet të rekomandojë procedurat e përgjithëshme për bashkëpunimin midis punëdhënësve, sa herë që dy ose më shumë ndërmarrje angazhohen njëherësh në aktivitete në të njëjtin shesh pune.

2.2. Politika dhe parimet në nivelin e ndërmarrjes

2.2.1. Për zbatimin e politikës kombëtare dhe parimeve të vendosura nga autoriteti kompetent, punëdhënësit, duke ndjekur konsultimet me punëtorët ose përfaqsesit e tyre, duhet të bëjnë udhëzime të mjaftueshme në nivelin e ndërmarrjes, sipas të cilave:

- (a) punëtorët, gjatë punës së tyre, të bashkëpunojnë me punëdhënësin për plotësimin e detyrimeve të marra përsipër;
- (b) punëtorët dhe përfaqsesit e tyre, si edhe punëdhënësi, të bashkëpunojnë në zbatimin e parimeve të vendosura;
- (c) punëtorët dhe përfaqsesit e tyre në ndërmarrje janë të paisur me informacionin e mjaftueshëm lidhur me masat e marra nga ana e punëdhënësit për zbatimin e politikës dhe parimeve të vendosura, dhe mund të konsultojnë organizatat e tyre përfaqësuese rreth një informacioni të tillë;
- (d) punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre në ndërmarrje u është dhënë trajnim i përshtatshëm lidhur me zbatimin e parimeve të vendosura.

2.2.2. Masat për zbatimin e politikës nuk duhet të shkaktojnë ndonjë shpenzim për punëtorët.

2.2.3. Sa herë që dy ose më shumë punëdhënës ndërmarrin njëherësh aktivitete në të njëjtin shesh pune, ata duhet të bashkëpunojnë për t'i bërë efektive udhëzimet për zbatimin e politikës. Autoriteti kompetent duhet të përgatisë procedurat e përgjithëshme të këtij bashkëpunimi, kur kjo është e nevojshme.

3. Udhëzimet ligjore, institucionale dhe administrative për ngritjen e sistemeve të raportimit, regjistrimit dhe njoftimit.

3.1. Të përgjithshmet

3.1.1. Nëpërmjet ligjeve dhe rregullave kombëtare, ose të ndonjë metode tjetër që është në përputhje me kushtet dhe praktikën kombëtare, autoriteti kompetent, duke ndjekur konsultimet me organizatat më përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve, duhet të përcaktojë konceptet dhe terminologjinë lidhur me regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme; këto duhet të jenë në përputhje me këtë kod, me marrëveshjet dhe rekomandimet ndërkombëtare, dhe duhet të nxisin harmonizimin e metodologjive dhe krahasueshmërinë e statistikave.

3.1.2. Autoriteti kompetent duhet që në veçanti:

- (a) të specifikojë se cilat kategori ose tipe të aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme, janë objekt i kërkesave për raportim, regjistrim dhe njoftim;
- (b) të vendosë dhe zbatojë kërkesa dhe procedura të njesuara për punëdhënësit dhe punëtorët në nivel të ndërmarrjes, për mjekët, shërbimet shëndetsore dhe organet e tjera, sipas përkatësisë, lidhur me raportimin dhe regjistrimin e aksidenteve në punë, të rasteve të vërtetë dhe rasteve të dyshuara të sëmundjeve profesionale, të aksidenteve gjatë lëvizjes, të ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme;
- (c) të vendosë dhe zbatojë kërkesa dhe procedura të njesuara për njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes dhe ngjarjeve të rrezikshme tek autoriteti kompetent, institucionet e sigurimeve, inspektoriatet e punës, shërbimet shëndetsore, si edhe tek autoritetet dhe organet e tjera të interesuara në mënyrë të drejtpërdrejtë, sipas rastit;
- (d) të bëjë udhëzimet e përshtatshme për bashkërendimin dhe bashkëpunimin e nevojshëm midis autoriteteve dhe organeve të ndryshme;
- (e) të bëjë udhëzimet e përshtatshme për njohuritë që duhet t'u jepen punëdhënësve dhe punëtorëve, për t'i ndihmuar këta që të plotësojnë detyrimet e tyre ligjore.

3.1.3. Këto kërkesa dhe procedura duhet të zbatohen për të gjithë punëtorët në të gjithë degët e aktivitetit ekonomik, pamvarësisht statusit të tyre në punësim, dhe nëpër të gjithë vendin, pa përjashtime.

3.1.4. Nëpërmjet ligjeve dhe rregullave, apo të ndonjë metode tjetër që është në përputhje me kushtet dhe praktikën kombëtare, autoriteti kompetent duhet:

- (a) të përgatisë një listë sëmundjesh, duke përfshirë të paktën sëmundjet e renditura në versionin më të fundit të Katalogut të I-rë të Konventës së Përfitimeve nga Dëmtimet në Punë, 1964 (Nr. 121) (versioni aktualisht në fuqi, ashtu siç është ndryshuar më 1980, është dhënë në Shtojcën A të këtij kodi), të cilat duhet të konsiderohen si sëmundjet profesionale në kushtet e rekomanduara; ose
- (b) të përfshijë në legjislacionin e tij një përcaktim të përgjithshëm të sëmundjeve profesionale, aq të gjërë sa të mbulojë të paktën sëmundjet e renditura në Katalogun e I-rë të Konventës së sipër përmendur; ose
- (c) të përgatisë një listë të sëmundjeve në përputhje me nën-paragrafin e mësipërm (a), të shoqëruar nga një përcaktim i përgjithshëm i sëmundjeve profesionale, dhe të hartojë dispozita të tjera, si për shembull, një sistem klasifikimi për vendosjen e origjinës profesionale të sëmundjeve, të pa renditura si të tilla, apo që e paraqesin vehten e tyre në kushte të ndyshme nga ato tashmë të rekomanduara.

3.1.5. Autoriteti kompetent duhet që periodikisht të rishikojë listën e përgatitur të sëmundjeve profesionale dhe ta zgjerojë atë në mënyrë progresive. Ai mund të marrë në konsideratë përmbajtjen e Shtojcës B të këtij kodi, si një shëmbull i sëmundjeve profesionale të propozuara për t'u përfshirë në një listë të tillë.

3.1.6. Autoriteti kompetent duhet të sigurojë nëpërmjet mjeteve dhe masave të përshtatshme, që lista e përgatitur e sëmundjeve profesionale të jetë bërë publike dhe të jetë vënë në dispozicion të mjekëve, shërbimeve shëndetsore, institucioneve të sigurimeve, punëdhënësve dhe punëtorëve, si edhe të organizatave të tyre përfaqësuese.

3.1.7. Autoriteti kompetent, nëpërmjet ligjeve dhe rregullave kombëtare, duhet të kërkojë bashkërendimin e udhëzimeve të rekomanduara nga Konventa e Përfitimeve nga Dëmtimi në Punë, 1964 (Nr. 121), si edhe të udhëzimeve për regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme.

3.1.8. Në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare, punëdhënësi duhet të sigurojë që udhëzimet të jenë bërë brenda ndërmarrjes dhe që ato të plotësojnë kërkesat për regjistrimin dhe njoftimin e informacionit në lidhje me:

- (a) sistemin e përfitimeve në rastin e dëmtimeve në punë apo sëmundjeve profesionale;
dhe
- (b) sistemin për regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme.

3.1.9. Punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre në ndërmarrje duhet t'u jepet nga ana e punëdhënësit informacioni i nevojshëm lidhur me udhëzimet për regjistrimin dhe njoftimin e informacionit të kërkuar për përfitimet në rastin e dëmtimeve në punë dhe sëmundjeve profesionale, si edhe për raportimin, regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme.

3.2. Klasifikimi i informacionit që duhet të regjistrohet dhe njoftohet

3.2.1. Autoriteti kompetent duhet të përgatisë udhëzimet e nevojshme për klasifikimin e informacionit, për të cilin ai ka marrë njoftim, dhe duhet të nxisë klasifikimin e llojeve të veçanta të informacionit, të mbajtura si dokumenta në nivelin e ndërmarrjes. Klasifikimi që do të përdoret duhet të përshtatet me versionet më të fundit të klasifikimeve ndërkombëtare të miratuara, ose me sistemet e klasifikimit të dhëna në këtë kod, siç vazhdon më poshtë:

- (a) *aktiviteti ekonomik i ndërmarrjes apo institucionit punëdhënës:*
me Klasifikimin Ndërkombëtar Standart Industrial i të gjithë Aktiviteteve Ekonomike—ISIC (struktura e gjërë e versionit më të fundit, miratuar më 1989, është dhënë në Shtojcën C të këtij kodi), ose me klasifikimin industrial të shndrrueshëm në këtë standart ndërkombëtar;
- (b) *profesioni:*
me Klasifikimin Ndërkombëtar Standart të Profesioneve — ISCO (klasifikimi i versionit më të fundit, ISCO-88, është dhënë në Shtojcën D të këtij kodi), ose me klasifikimin e profesioneve të shndrrueshëm në këtë standart ndërkombëtar;
- (c) *statusi në punësim:*
me Klasifikimin Ndërkombëtar të Statusit në Punësim — ICSE (klasifikimi i versionit më të fundit, siç është miratuar më 1993, jepet në Shtojcën E të këtij kodi);
- (d) *natyra dhe vendndodhja trupore e dëmtimit, tipi i aksidentit, mjeti i lidhur me dëmtimin ose aksidentin:*
Shtojcat F, G, H dhe I të këtij kodi japin respektivisht versionet më të fundit të klasifikimeve për qëllime statistikore.

3.2.2. Autoriteti kompetent, pas konsultimit me organizatat më përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve, duhet të nxisë zhvillimin e një sistemi klasifikimi për ekspozimet ndaj faktorëve fizikë, kimikë dhe biologjikë në mjedisin e punës.

4. Raportimi në nivelin e ndërmarrjes

4.1. Punëdhënësi, pas konsultimeve me punëtorët dhe përfaqsesit e tyre në ndërmarrje, duhet të ndërtojë udhëzimet, në pajtim me ligjet ose rregullat kombëtare, për t'i mundësuar punëtorët të veprojnë në përputhje me kërkesat e raportimit të menjëhershëm tek eprori i tyre i drejtpërdrejtë, pa dëmtuar vehten, për çdo situatë për të cilën ata kanë arsye të justifikueshme të mendojnë se përfaqson një rrezik kërcënues dhe serioz për jetën dhe shëndetin.

4.2. Punëdhënësi, pas konsultimeve me punëtorët dhe përfaqsesit e tyre në ndërmarrje, duhet të ndërtojë udhëzimet në pajtim me ligjet ose rregullat kombëtare, për t'i mundësuar punëtorët të veprojnë në përputhje me kërkesat për të raportuar çdo dëmtim në punë, rast të dyshuar të sëmundjes profesionale, aksident gjatë lëvizjes, ngjarje dhe incident të rrezikshëm.

4.3. Këto udhëzime duhet të përfshijnë:

- (a) dhënien e informacionit nga ana e punëtorëve, përfaqsesve të punëtorëve, mjekëve dhe personave të tjerë përkatës, lidhur me aksidentet në punë, sëmundjet profesionale, ngjarjet dhe incidentet e rrezikshme në ndërmarrje, dhe aksidentet gjatë lëvizjes;
- (b) identifikimin e personit kompetent, kur është e përshtatshme:
 - (i) për marrjen e këtij informacioni në emër të punëdhënësit dhe për ndërmarrjen e veprimit të përshtatshëm; dhe
 - (ii) për hetimin përkatës në emër të punëdhënësit, që bëhet në vazhdim të marrjes së këtij informacioni;
- (c) masat për sigurimin e fshehtësisë së të dhënave personale dhe mjekësore në zotërim të punëdhënësit, në përputhje me ligjet dhe rregullat, me kushtet dhe praktikën kombëtare.

5. Udhëzimet për regjistrimin

5.1. Në nivelin kombëtar

5.1.1. Ligjet ose rregullat kombëtare duhet të kërkojnë që punëdhënësit të krijojnë dhe të mbajnë të dhëna të regjistruara lidhur me aksidentet në punë, sëmundjet profesionale, aksidentet gjatë lëvizjes, ngjarjet dhe ndodhitë e rrezikshme, siç është përcaktuar nga ana e autoritetit kompetent.

5.1.2. Ligjet ose rregullat kombëtare duhet të paracaktojnë se cilat të dhëna dhe informacione duhet të regjistrohen, me qëllim që të jetë e sigurt se që të gjithë të dhënat dhe informacioni i kërkuar janë mbledhur në mënyrë sistematike, si edhe të japin metodologjinë për hetimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, ngjarjeve dhe ndodhive të rrezikshme. Në rastin kur për këtë qëllim përdoren formularë, ato duhet të njesohen.

5.1.3. Informacioni që kërkohet të regjistrohet në nivelin e ndërmarrjes, duhet të përfshijë të paktën informacionin që duhet të njoftohet, ashtu siç është vendosur në Kapitullin e 6-të të këtij kodi.

5.1.4. Ligjet dhe rregullat kombëtare duhet të specifikojnë informacionin shtesë që duhet të regjistrohet nga ana e punëdhënësve, edhe sikur ai të mos kërkohet që të njoftohet. Kjo duhet të zbatohet në rastin e:

- (a) incidenteve ku nuk shihet një dëmtim i menjëhershëm personal;
- (b) kategorive të veçanta të ngjarjeve të rrezikshme;
- (c) aksidenteve gjatë lëvizjes, në rast se është e zbatueshme.

5.1.5. Ligjet dhe rregullat kombëtare duhet të specifikojnë në veçanti:

- (a) përmbajtjen dhe formatin e të dhënave të regjistruara;
- (b) periudhën e kohës gjatë së cilës mblidhen këto të dhëna;
- (c) periudhën e kohës gjatë së cilës duhet të ruhen të dhënat e regjistruara;
- (d) që këto të dhëna të regjistruara mblidhen dhe mbahen në një mënyrë që respekton fshehtësinë e të dhënave personale dhe mjekësore në përputhje me ligjet dhe rregullat, kushtet dhe praktikën kombëtare, dhe janë në përputhje me paragrafin 6 të Rekomandimit të Shërbimeve të Shëndetit në Punë, 1985 (Nr. 171);
- (e) që punëdhënësi duhet të identifikojë personin kompetent në nivelin e ndërmarrjes, për të përgatitur dhe mbajtur të dhënat e regjistruara; dhe
- (f) bashkëpunimin në procedurat regjistruese, kur dy ose më shumë punëdhënës angazhohen në aktivitete njëherësh dhe në të njëjtin shesh pune.

5.2. Në nivelin e ndërmarrjes

5.2.1. Punëdhënësi duhet të ndërtojë udhëzime në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare për të regjistruar aksidentet në punë, sëmundjet profesionale, aksidentet gjatë lëvizjes, ngjarjet dhe incidentet e rrezikshme.

5.2.2. Këto udhëzime duhet të përfshijnë:

- (a) identifikimin e personit kompetent për të përgatitur dhe mbajtur të dhënat e regjistruara të të gjithë aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme, ashtu siç kërkohet nga ligjet dhe rregullat kombëtare; dhe
- (b) bashkëpunimin në procedurat regjistruese, në rastin kur dy ose më shumë punëdhënës angazhohen në aktivitete njëherësh dhe në të njëjtin shesh pune, ashtu siç kërkohet nga ligjet dhe rregullat kombëtare.

5.2.3. Punëdhënësi duhet të bëjë të mundur që të dhënat e regjistruara mbi aksidentet në punë, sëmundjet profesionale, aksidentet gjatë lëvizjes, ngjarjet dhe incidentet e rrezikshme, të jenë të disponueshme dhe menjëherë të tërheqshme në të gjithë kohët e arsyeshme.

5.2.4. Në rastet kur në një aksident të vetëm në punë dëmtohen më shumë se një punëtor, duhet bërë regjistrimi për secilin nga punëtorët e dëmtuar.

5.2.5. Raportet e sigurimit të kompensimit të punëtorëve dhe raportet e aksidenteve që duhen dorëzuar për njoftim, janë të pranueshme për të qënë të dhëna të regjistruara, në rast se ato përmbajnë të gjithë faktet e kërkuar për procesin e regjistrimit, apo janë të plotësuara në një mënyrë të përshtatshme.

5.2.6. Për qëllime inspektimi dhe si informacion për t'u përdorur nga përfaqësuesit e punëtorëve dhe shërbimet shëndetsore, punëdhënësit duhet të përgatisin të dhëna të regjistruara brenda një periudhe kohe që duhet të përcaktohet nga ana e autoritetit kompetent, por mundësisht brenda gjashtë ditëve pas ndodhjes së raportimit.

5.2.7. Punëtorët, gjatë realizimit të punës së tyre, duhet të bashkëveprojnë me punëdhënësin në realizimin e udhëzimeve brenda ndërmarrjes për regjistrimin dhe njoftimin e aksienteve ne punë, sëmundjeve profesionale dhe ngjarjeve të rrezikshme.

5.2.8. Punëdhënësi duhet t'u japë punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre informacionin e përshtatshëm lidhur me:

- (a) udhëzimet për regjistrimin; dhe
- (b) personin kompetent të zgjedhur nga ana e punëdhënësit për marrjen dhe regjistrimin e informacionit mbi aksidentet në punë, sëmundjet profesionale, aksidentet gjatë lëvizjes, ngjarjet dhe incidentet e rrezikshme.

5.2.9. Punëdhënësi duhet t'u japë punëtorëve ose përfaqësuesve të tyre informacionin e përshtatshëm lidhur me të gjithë aksidentet në punë, sëmundjet

profesionale, ngjarjet dhe incidentet e rrezikshme në ndërmarrje, si edhe me aksidentet gjatë lëvizjes, për të asistuar në këtë mënyrë punëtorët dhe punëdhënësit në pakësimin e rrezikut të ekspozimit ndaj ngjarjeve të njëjta.

6. Udhëzimet për njoftimin

6.1. Në nivelin kombëtar

6.1.1. Autoritetet kompetente, nëpërmjet ligjeve dhe rregullave kombëtare apo të ndonjë metode tjetër që është në përputhje me kushtet dhe praktikën kombëtare, duhet të vendosin dhe zbatojnë procedurat për njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, ngjarjeve të rrezikshme dhe aksidenteve gjatë lëvizjes, sipas përkatësisë.

6.1.2. Duhet siguruar një bashkëpunim i ngushtë midis autoritetit ose autoriteteve kompetente, autoriteteve publike dhe organizatave përfaqesuese të punëdhënësve dhe punëtorëve, si edhe organeve të tjerë që janë të interesuar në formulimin dhe zbatimin e procedurave të përmendura më sipër në paragrafin 6.1.1.

6.1.3. Ligjet dhe rregullat kombëtare duhet të specifikojnë që aksidentet në punë, sëmundjet profesionale, aksidentet gjatë lëvizjes dhe ngjarjet e rrezikshme, të njoftohen sipas përkatësisë, tek:

- (a) organi përkatës detyruar (për shembull, inspektoriat i punës);
- (b) institucioni i sigurve përkatës;
- (c) organi që përgatit statistikat; ose
- (d) çdo organ tjetër.

6.1.4. Ligjet dhe rregullat kombëtare duhet të specifikojnë:

- (a) informacionin përkatës lidhur me aksidentet në punë, sëmundjet profesionale, ngjarjet e rrezikshme dhe aksidentet gjatë lëvizjes, sipas përshtatshmërisë, që do t'i njoftohet autoritetit kompetent, inspektoriatit të punës, institucionit sigurve apo organeve të tjera;
- (b) përfazimin e njoftimit, që mundësisht duhet të bëhet nga punëdhënësi:
 - (i) nëpërmjet mjeteve më të shpejtë të mundshëm, menjëherë pas raportimit të aksidentit në punë që shkakton humbjen e jetës;
 - (ii) brenda një kohe të paracaktuar për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale të tjera;
- (c) formularin e njesuar të njoftimit, për t'u përdorur për dorëzimin e njoftimeve tek autoriteti kompetent, inspektoriat i punës, institucioni i sigurimit ose organet e tjerë;
- (d) që punëdhënësi identifikon personin kompetent për njoftim në nivelin e ndërmarrjes;
- (e) përgjegjësitë, udhëzimet dhe procedurat e përshtatshme që i mundësojnë punëdhënësit të bashkëpunojnë në procedurën e njoftimit, kur dy ose më shumë ndërmarrje angazhohen në aktivitete njëherësh dhe në të njëjtin shesh pune; dhe
- (f) sistemet që do të përdoren për klasifikimin e informacionit (shih seksionin 3.2 të këtij kodi).

6.1.5. Ligjet dhe rregullat kombëtare duhet të specifikojnë që njoftimi i sëmundjes profesionale nga ana e punëdhënësit është i detyrueshëm, të paktën në rastet kur punëdhënësi merr çertifikatë mjekësore lidhur me pasojat që një nga punëtorët e tij po vuan si rrjedhim i sëmundjes profesionale.

6.1.6. Po qe se nevojitet informacion më i detajuar në krahasim me atë që kërkon procesi i njoftimit, ligjet dhe rregullat kombëtare duhet të specifikojnë:

- (a) përmbajtjen dhe formatin e raporteve zyrtarë që mbrijnë tek autoriteti kompetent dhe që mbartin informacionin shtesë;
- (b) shpeshësinë dhe mënyrën se si këto raporte përgatiten nga punëdhënësit dhe dërgohen tek autoriteti kompetent.

6.1.7. Autoriteti kompetent duhet t'i regjistrojë njoftimet në atë mënyrë që t'i bëjë ato të përdorshme për përpilimin e statistikave të përshtatshme, duke përdorur sistemet e klasifikimit të përmendura në paragrafin 3.2 të këtij kodi, si edhe për bërjen e analizave.

6.2. Në nivelin e ndërmarrjes

6.2.1. Punëdhënësi, pas konsultimit me punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre, duhet të ndërtojë udhëzime brenda ndërmarrjes, në pajtim me ligjet dhe rregullat kombëtare, për të njoftuar aksidentet në punë, sëmundjet profesionale, ngjarjet e rrezikshme dhe aksidentet gjatë lëvizjes, sipas përkatësisë.

6.2.2. Udhëzimet brenda ndërmarrjes do të përfshijnë:

- (a) identifikimin e personit kompetent për përgatitjen e njoftimit përkatës, për t'u dorëzuar nga ana e punëdhënësit;
- (b) përcaktimin e përgjegjesisë për njoftimin, kur dy ose më shumë punëdhënës angazhohen në aktivitete njëherësh dhe në të njëjtin shesh pune, ashtu siç kërkohet nga ligjet dhe rregullat kombëtare.

6.3. Njoftimi i aksidenteve në punë

6.3.1. Të përgjithshmet

6.3.1.1. Të gjithë aksidentet në punë duhet të njoftohen, siç kërkohet nga ligjet dhe rregullat kombëtare, tek autoriteti kompetent, inspektoriati i punës, institucioni përkatës i sigurimit, ose tek çdo organ tjetër:

- (a) menjëherë, pas raportimit të një aksidenti në punë që shkakton humbjen e jetës;
- (b) brenda një periudhe kohe të përcaktuar, për aksidentet e tjerë në punë.

6.3.1.2. Njoftimi duhet të bëhet në aq kohë sa ç'mund të jetë specifikuar dhe nëpërmjet formularëve të veçantë të parapërgatitur, si për shembull:

- (a) raport aksidenti për inspektoriatin e punës;
- (b) raport kompensimi për institucionin e sigurimit;
- (c) raport për organin që përgatit statistika; ose
- (d) një formular i vetëm, i cili përmban të gjithë informacionin e domosdoshëm për të gjithë organet.

6.3.2. Informacioni minimal

6.3.2.1. Me qëllim që të arrihen kërkesat e inspektoriateve të punës, institucioneve siguroese dhe organit që përgatit statistika, formularët e ndërtuar në një format të veçantë apo unik, duhet të përfshijnë të paktën informacionin në vazhdim:

- (a) firmën, ndërmarrjen dhe punëdhënësin:
 - (i) emrin dhe adresën e punëdhënësit, numrat e telefonit dhe të faksit (po qe se janë të disponueshëm);
 - (ii) emrin dhe adresën e firmës;
 - (iii) emrin dhe adresën e ndërmarrjes (po qe se është e ndryshme);
 - (iv) aktivitetin ekonomik të ndërmarrjes¹; dhe
 - (v) numrin e punëtorëve (madhësia e ndërmarrjes);
- (b) personin e dëmtuar:
 - (i) emrin, adresën, seksin dhe moshën;
 - (ii) statusin e punësimit²;
 - (iii) profesionin³;
- (c) dëmtimin:
 - (i) aksidentin vdekje-prurës;
 - (ii) aksidentin jo vdekje prurës;
 - (iii) natyrën e dëmtimit (psh, frakturë, etj.)⁴;
 - (iv) vendndodhjen e dëmtimit (psh, këmbë, etj.)⁵;
- (d) aksidentin dhe vazhdimësinë e tij:
 - (i) vendndodhjen gjeografike të vendit ku ndodhi aksidenti (vendi i zakonshëm i punës, një vend tjetër pune brenda ndërmarrjes ose jashtë ndërmarrjes);
 - (ii) datën dhe orën;
 - (iii) veprimin që çoi në dëmtim - tipin e aksidentit (për shembull, rrëzimi, etj.)⁶;
 - (iv) mjetin e lidhur me aksidentin (psh, shkallën, etj.)⁷.

¹ Shih paragrafin 3.2.1(a) dhe Shtojcën C.

² Shih paragrafin 3.2.1(c) dhe Shtojcën E.

³ Shih paragrafin 3.2.1(b) dhe Shtojcën D.

⁴ Shih Shtojcën F.

⁵ Shih Shtojcën G.

⁶ Shih Shtojcën H.

⁷ Shih Shtojcën I.

6.3.2.2. Për aksidentet gjatë lëvizjes, duhet të specifikohet informacioni përkatës i nevojshëm.

6.3.3. Informacioni më i detajuar

6.3.3.1. Ligjet ose rregullat kombëtare duhet të japin material për specifikimin e informacionit më të detajuar, i cili duhet të përfshijë sa më poshtë:

- (a) firmën, ndërmarrjen dhe punëdhënësin:
 - (i) emrin dhe adresën e punëdhënësit, numrat e telefonit dhe të faksit (po qe se janë të disponueshëm);
 - (ii) emrin dhe adresën e firmës;
 - (iii) emrin dhe adresën e ndërmarrjes (po qe se kjo është e ndryshme);
 - (iv) aktivitetin ekonomik të ndërmarrjes¹; dhe
 - (v) numrin e punëtorëve (madhësia e ndërmarrjes);
- (b) personin e dëmtuar:
 - (i) emrin, adresën, seksin dhe datën e lindjes;
 - (ii) statusin e punësimit²;
 - (iii) profesionin³;
 - (iv) vjetërsinë në punë me punëdhënësin aktual;
- (c) dëmtimin:
 - (i) aksidentin vdekje prurës;
 - (ii) aksidentin jo vdekje prurës;
 - (iii) natyrën e dëmtimit (për shembull, frakturën, etj.)⁴;
 - (iv) vendndodhjen e dëmtimit (për shembull, këmbën, etj.)⁵;
 - (v) paaftësinë për punë në ditë kalendarike;
- (d) aksidentin dhe vazhdimësinë e tij:
 - (i) vendndodhjen gjeografike të vendit të aksidentit (vendi i zakonshëm i punës, një vend pune tjetër brenda ndërmarrjes ose jashtë ndërmarrjes);
 - (ii) datën dhe orën;
 - (iii) turnin, kohën e fillimit të punës së personit të dëmtuar dhe orët e punës në aktivitetin në të cilin ndodhi aksidenti;
 - (iv) mjedisin e punës (për shembull, zonën e ndërmarrjes, zyrën, rrugën, etj.);
 - (v) procesin e punës (psh, saldimin, mirëmbajtjen, transportin me krahë, etj.);
 - (vi) aktivitetin e personit të dëmtuar në kohën e aksidentit (për shembull, duke salduar, duke mirëmbajtur një makinë presimi, duke drejtuar një makinë, duke ngarë një automobil, duke ecur, etj.);
 - (vii) elementin ose elementët e bashkëngjitur aktivitetit të personit të dëmtuar (për shembull, makinën, veglën, presën, automobilin, etj.);

¹ Shih paragrafin 3.2.1 (a) dhe Shtojcën C.

² Shih paragrafin 3.2.1 (c) dhe Aneksin E.

³ Shih paragrafin 3.2.1 (b) dhe Aneksin D.

⁴ Shih Aneksin F.

⁵ Shih Aneksin G.

- (viii) veprimin që çoi në dëmtim - tipin e aksidentit (për shembull, rrëzimin, etj.)¹;
- (ix) mjetin e lidhur me dëmtimin (për shembull, shkallën, etj.)².

6.3.3.2. Përsa i përket aksidenteve gjatë lëvizjes, informacioni i nevojshëm përkatës për t'u njoftuar, duhet të specifikohet.

6.4. Njoftimi i sëmundjeve profesionale

6.4.1. Ligjet ose rregullat kombëtare duhet të specifikojnë që njoftimi i aksidenteve në punë përfshin të paktën informacionin në vazhdim:

- (a) firmën, ndërmarrjen dhe punëdhënësin:
 - (i) emrin dhe adresën e punëdhënësit dhe numrat e tij të telefonit dhe faksit (po qe se janë të disponueshëm);
 - (ii) emrin dhe adresën e firmës;
 - (iii) emrin dhe adresën e ndërmarrjes (po qe se ajo është e ndryshme);
 - (iv) aktivitetin ekonomik të ndërmarrjes³; dhe
 - (v) numrin e punëtorëve (madhësia e ndërmarrjes);
- (b) personin e prekur nga sëmundja profesionale:
 - (i) emrin, adresën, seksin dhe datën e lindjes;
 - (ii) statusin e punësimit⁴;
 - (iii) profesionin në kohën kur u diagnostikua sëmundja; dhe
 - (iv) vjetërsinë në punë me punëdhënësin aktual;
- (c) sëmundjen profesionale:
 - (i) emrin dhe natyrën e sëmundjes profesionale;
 - (ii) mjetet e dëmshme, proceset ose ekspozimin, të cilëve u atribuohet sëmundja profesionale;
 - (iii) përshkrimin e punës që bëri të lindë rrethana;
 - (iv) kohë-zgjatjen e ekspozimit ndaj agjentëve dhe proceseve të dëmshëm;
 - (v) datën e diagnostikimit të sëmundjes profesionale.

6.5. Njoftimi i ngjarjeve të rrezikshme

6.5.1. Ligjet ose rregullat kombëtare duhet të specifikojnë që njoftimi i ngjarjes së rrezikshme, i ndodhur në lidhje me aktivitetet e punës dhe që për të cilën kërkohet të njoftohen autoritetet kompetente, përfshin të paktën informacionin në vazhdim:

- (a) firmën, ndërmarrjen dhe punëdhënësin:

¹ Shih Shtojcën H.

² Shih Shtojcën I.

³ Shih paragrafin 3.2.1 (a) dhe Shtojcën C.

⁴ Shih paragrafin 3.2.1(c) dhe Shtojcën E.

- (i) emrin dhe adresën e punëdhënësit, numrat e tij të telefonit dhe faksit (po qe se janë të disponueshëm);
 - (ii) emrin dhe adresën e firmës;
 - (iii) emrin dhe adresën e ndërmarrjes (po qe se ajo është e ndryshme);
 - (iv) aktivitetin ekonomik të ndërmarrjes¹; dhe
 - (v) numrin e punëtorëve (madhësia e ndërmarrjes)²;
- (b) Ngjarjen e rrezikshme:
- (i) datën, kohën dhe vendin;
 - (ii) tipin e ngjarjes së rrezikshme;
 - (iii) rrethanat që çuan tek ngjarja e rrezikshme.

¹ Shih paragrafin 3.2.1(a) dhe Shtojcën C.

² Shih paragrafin 3.2.1(a) dhe Shtojcën E.

7. Shtrirja e sistemeve të regjistrimit dhe njoftimit tek personat e vet-punësuar

7.1. Në nivelin kombëtar

7.1.1. Ligjet ose rregullat kombëtare lidhur me raportimin, regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme, duhet të zbatohen gjithashtu edhe ndaj personave të vet-punësuar¹, siç është specifikuar nga ana e autoritetit kompetent.

7.1.2. Ligjet ose rregullat kombëtare duhet të specifikojnë që njoftimi i autoriteteve kompetente lidhur me aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe ngjarjet e rrezikshme që kanë të bëjnë me personat e vet-punësuar në ndërmarrjen që është pronë e tyre, duhet të dorëzohet si në vazhdim:

- (a) në rastin e vdekjes ose të një aksidenti jo vdekje prurës në punë, të sëmundjes profesionale ose ngjarjeve të rrezikshme që e bëjnë personin e vet-punësuar të paaftë për dorëzimin e njoftimit, njoftimi duhet të dorëzohet nga personi që ka nën kontroll ndërmarrjen ose, siç mund të jetë paracaktuar nga ana e autoritetit kompetent;
- (b) në rastet e tjera, njoftimi duhet të dorëzohet nga vetë personat e vet-punësuar.

7.1.3. Ligjet ose rregullat kombëtare duhet të specifikojnë që njoftimi i autoritetit kompetent lidhur me aksidentet në punë të personave të vet-punësuar në ndërmarrjet që nuk janë pronë e tyre, duhet të:

- (a) regjistrohet dhe njoftohet nga ana e punëdhënësit të ndërmarrjes, në të cilën i ishte kërkuar që të punonte personi i vet-punësuar;
- (b) njoftohet nga ana e personit të vet-punësuar tek institucioni i tij i sigurimit, me një dokument siç kërkohet në paragrafin 7.1.3(a) më sipër.

7.2. Në nivelin e ndërmarrjes

7.2.1. Personi në kontroll të ndërmarrjes ku është kontraktuar për të punuar personi i vet-punësuar, duhet të përgatisë udhëzimet për raportimin, regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme, të cilat mund të zbatohen ndaj personave të vet-punësuar.

¹ Siç mund të jetë përcaktuar nga versioni më i fundit i Klasifikimit Ndërkombëtar të Statusit në Punësim (ICSE) — shih Shtojcën E.

7.3. Personi i vet-punësuar

7.3.1. Personi i vet-punësuar duhet të bashkëveprojë me personin në kontroll të ndërmarrjes ku ai është kontraktuar për të punuar, për të bërë të mundur njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes dhe ngjarjeve të rrezikshme.

7.3.2. Personi i vet-punësuar, në pajtim me ligjet ose rregullat kombëtare, duhet të dorëzojë tek autoritetet kompetente njoftimin për aksidentet jo vdekje prurës në punë, sëmundjet profesionale, aksidentet gjatë lëvizjes dhe ngjarjet e rrezikshme. Në rast se ai nuk është në gjëndje për ta bërë këtë, personi i vet-punësuar duhet të përgatisë udhëzimet e përshtatshme alternative.

8. Statistikat e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes dhe ngjarjeve të rrezikshme: Përpilimi dhe publikimi

8.1. Në nivelin kombëtar

8.1.1. Autoriteti kompetent duhet të marrë masa për përpilimin dhe publikimin, të paktën një herë në vit, të statistikave lidhur me aksidentet në punë, sëmundjet profesionale, aksidentet gjatë lëvizjes dhe ngjarjet e rrezikshme, në bazë të informacionit të njoftuar atij.

8.1.2. Kur është e realizueshme, statistikat duhet të përpilohen nga ana e autoritetit kompetent bazuar tek njoftimet e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes dhe ngjarjeve të rrezikshme, pa pasur nevoja burimore për raporte shtesë.

8.1.3. Njësia matëse për t'u regjistruar duhet të jetë:

- (a) personi i vrarë ose i dëmtuar si pasojë e aksidentit në punë ose aksidentit gjatë lëvizjes;
- (b) personi i prekur si pasojë e sëmundjes profesionale; ose
- (c) ngjarja e rrezikshme.

8.1.4. Kur një person, gjatë periudhës së mbuluar nga statistikat, ka vuajtur më shumë se një aksident të veçuar në punë ose sëmundje profesionale, ai duhet të llogaritet veçmas lidhur me çdo aksident ose sëmundje.

8.1.5. Periudha që mbulohet nga statistikat duhet të jetë e përcaktuar qartë dhe, në rastin më të mirë, nuk duhet ta kapërcejë vitin kalendarik.

8.1.6. Informacioni lidhur me aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale të personave të vet-punësuar, si edhe me aksidentet gjatë lëvizjes, duhet të përfshihet në statistika; sidoqoftë, një informacion i tillë duhet të paraqitet veçmas, në mënyrë që të mund të bëhen krahasime të përshatshme me vendet që nuk e përfshijnë një informacion të tillë në statistikat e tyre kombëtare.

8.1.7. Duke paraqitur statistikat lidhur me aksidentet në punë, sëmundjet profesionale, aksidentet gjatë lëvizjes dhe ngjarjet e rrezikshme, autoriteti kompetent duhet të bëjë të mundur që ky informacion të jepet lidhur me:

- (a) natyrën e burimeve të statistikave; për shembull, raportimi i drejtpërdrejtë nga ana e punëdhënësve dhe organeve të ndryshme, të themi – nga institucionet e sigurimeve ose inspektoriatet e punës;
- (b) hapësirën vepruese të statistikave, veçanërisht lidhur me kategoritë e personave, degët e aktivitetit ekonomik, profesionet, madhësinë e ndërmarrjes, shtetet përbërës të një vendi apo rajoneve;
- (c) përkufizimet e përdorura;
- (d) metodat e përdorura për regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes dhe ngjarjeve të rrezikshme, si edhe për përpilimin e statistikave;
- (e) cilësinë e statistikave;
- (f) statistikatat paraprake, kur ato janë të disponueshme.

8.1.8. Gjatë hartimit ose rishikimit të koncepteve, përkufizimeve dhe metodologjisë së përdorur gjatë grumbullimit, përpilimit dhe publikimit të statistikave të tilla, autoriteti kompetent duhet të marrë në konsideratë standartet dhe udhëzuesit më të fundit të krijuar nën patronazhin e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), ose të organizatave të tjera ndërkombëtare, që kanë lidhje me këtë çështje.

8.1.9. Në hartimin ose rishikimin e koncepteve, përkufizimeve dhe metodologjisë së përdorur gjatë përpilimit dhe publikimit të statistikave të tilla, autoriteti kompetent duhet të konsultohet me organizatat më përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve.

8.1.10. Gjatë publikimit të të dhënave statistikore mbi aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe ngjarjet e rrezikshme, autoriteti kompetent duhet të bëjë të mundur që norma e shpeshhtësisë, norma e prekshmërisë dhe norma e ashpërsisë, kur është e përshtatshme, të llogariten për ndarjet më të mëdha të aktivitetit ekonomik (shih klasifikimin në paragrafin 3.2.1(a) të këtij kodi), për profesionin (shih klasifikimin në paragrafin 3.2.1(b) të këtij kodi), grup-moshën, seksin dhe grupet e tjera, që duhet të specifikohen.

8.2. Regjistrimi dhe njoftimi në mënyrë progresive i informacionit më të detajuar

8.2.1. Ligjet ose rregullat kombëtare duhet të parashikojnë specifikimin e informacionit progresivisht më të detajuar, për t'u përfshirë në të dhënat e regjistruara, dhe për njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes dhe ngjarjeve të rrezikshme.

8.2.2. Përpara specifikimit të kërkesave për informacionin më të detajuar, autoriteti kompetent duhet të konsultohet me organizatat më përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve.

8.2.3. Autoriteti kompetent, siç specifikohet nga ligjet ose rregullat kombëtare, duhet të përcaktojë për punëdhënësit një periudhë kohe të arësyeshme, në mënyrë që ata

të jenë në gjëndje të japin informacionin më të detajuar të kërkuar për regjistrimet dhe njoftimet e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe ngjarjeve të rrezikshme.

9. Statistikat e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe ngjarjeve të rrezikshme: Klasifikimet¹

9.1. Të përgjithshmet

9.1.1. Statistikat e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe ngjarjeve të rrezikshme, duhet të klasifikohen të paktën sipas degës së aktivitetit ekonomik dhe, kur kjo është e mundur, sipas:

- (a) karakteristikave të rëndësishme të punëtorëve, si për shembull, statusit në punësim, seksit, moshës ose grup moshës; dhe
- (b) karakteristikave të rëndësishme të ndërmarrjes.

9.2. Aksidentet në punë

9.2.1. Aksidentet në punë duhet fillimisht të klasifikohen si në vazhdim:

- (a) numri i përgjithshëm i viktimave, i ndarë në:
 - (i) aksidentet që përfundojnë me vdekje;
 - (ii) dëmtimet jo vdekje prurëse që përfundojnë me paaftësi për punë për të paktën tre ditët që pasojnë, duke përjashtuar ditën e aksidentit;
- (b) shuma e ditëve të humbura, duke përfshirë tre ditët e para, për dëmtimet jo vdekje prurëse.

9.2.2. Meqënëse informacioni më i detajuar bëhet progresivisht më shpejt i disponueshëm, autoriteti kompetent duhet që, sa më shpejt që të jetë e zbatueshme, t'i klasifikojë aksidentet si në vazhdim:

- (a) numri i përgjithshëm i viktimave:
 - (i) të aksidenteve që rezultojnë me vdekje, të ndarë në vdekje që kanë ndodhur brenda 30 ditëve nga dita e aksidentit, dhe në vdekje që kanë ndodhur midis ditës së 31 dhe asaj të 365 nga dita e aksidentit;
 - (ii) të aksidenteve jo vdekje-prurës, të ndarë në kategoritë në vazhdim: jo me humbje kohe ose mungesë në punë (siç është specifikuar në përkufizimin kombëtar); me humbje kohe (duke përjashtuar ditën e aksidentit) deri në tre ditë, dhe në më shumë se tre ditë;

¹ Bazuar në rezolutën lidhur me statistikat e dëmtimeve në punë. Konferenca e Trembëdhjetë Ndërkombëtare e Stacioneve të Punës, Gjenevë, 18-29 Tetor 1982.

- (b) shuma e ditëve të humbura në dëmtimet jo vdekje prurëse, e ndarë në kategoritë në vazhdim: humbje kohe deri në tre ditë dhe në më shumë se tre ditë.

9.2.3. Atje ku është e mundshme, statistikat e aksidenteve në punë të përpiluara nga autoriteti kompetent, duhet të tregojnë:

- (a) shumën e përgjithshme për çdo pikë të paragrafëve 9.2.2(a) dhe 9.2.2(b) më sipër; dhe
- (b) zbërthimin përkatës të saj.

9.2.4. Autoriteti kompetent duhet ta bëjë të qartë nëse koha e humbur e treguar në statistikat e aksidenteve në punë është matur në ditë kalendarike, ditë jave, ditë pune apo turne pune.

9.2.5. Periudha e mbuluar nga statistikat e aksidenteve në punë nuk duhet të kapërcejë vitin kalendarik.

9.2.6. Statistikat mbi aksidentet gjatë lëvizjes dhe për personat e vet-punësuar, duhet të jepen veçmas.

9.3. Sëmundjet profesionale

9.3.1. Statistikat e sëmundjeve profesionale të publikuara nga autoriteti kompetent, duhet të japin numrin e përgjithshëm të rasteve të raportuar për çdonjerën nga sëmundjet e përfshira në listën e sëmundjeve profesionale, të parapërgatitur nga ana e autoriteteve kompetente.

9.3.2. Periudha e mbuluar nga statistikat e sëmundjeve profesionale nuk duhet të kapërcejë vitin kalendarik.

9.3.3. Statistikat mbi sëmundjet profesionale për personat e vet-punësuar, duhet të jepen veçmas.

9.4. Ngjarjet e rrezikshme

9.4.1. Autoriteti kompetent duhet të publikojë statistika mbi numrat dhe tipet e ngjarjeve të rrezikshme, që janë njoftuar.

10. Hetimi i aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme

10.1. Në nivelin kombëtar

10.1.1. Në përkrahje të politikave kombëtare lidhur me sigurinë në punë, shëndetin në punë dhe mjedisin ku punohet, si edhe të politikës kombëtare për parandalimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, autoriteti kompetent duhet të marrë masa për hetimin e një numri dhe llojshmërie tipesh të mjaftueshëm të aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes dhe ngjarjeve të rrezikshme, me synim që të jetë në gjëndje të:

- (a) verifikojë efektivitetin e këtyre politikave;
- (b) përcaktojë nëse janë të nevojshme ndryshimet për këto politika, apo për ligjet ose rregullat kombëtare; dhe
- (c) verifikojë efektivitetin në të dy nivelet, në atë kombëtar dhe të ndërmarrjes, të udhëzimeve për regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes dhe ngjarjeve të rrezikshme.

10.1.2. Ligjet ose rregullat kombëtare lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë, si edhe me mjedisin ku punohet, duhet të specifikojnë që autoriteti kompetent mund të ndërtojë udhëzime të mjaftueshme dhe sisteme të përshtatshme hetimi të aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes dhe ngjarjeve të rrezikshme.

10.1.3. Autoriteti kompetent duhet të organizojë hetime, për t'u realizuar nga ana e inspektoriateve të punës ose nga ana e agjensive të tjera të autorizuar. Përfaqsesit e punëdhënësve dhe të punëtorëve të ndërmarrjes duhet të kenë mundësinë të shoqërojnë të ngarkuarit me hetimin, përveçse kur këta të fundit, nën dritën e instruksioneve të përgjithshme të autoritetit kompetent, gjykojnë që ky veprim do të dëmtojë realizimin e detyrave të tyre.

10.1.4. Në rastin kur hetimi nuk i është besuar ndonjë institucioni të autorizuar nga ana e autoritetit kompetent, apo ndonjë departamenti qeveritar përgjegjës përpara parlamentit, atëherë ligjet ose rregullat kombëtare duhet të specifikojnë udhëzimet për pjesëmarrjen e organizatave më përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve, si edhe të autoriteteve publike, në planifikimin e hetimit, po ashtu edhe të pjesëmarrjes në hetime të përfaqësuesve të punëdhënësve edhe të punëtorëve të prekur, siç është specifikuar në paragrafin 10.1.3 më sipër.

10.1.5. Autoriteti kompetent duhet të bëjë hetime dhe të publikojë raporte mbi këto hetime, për rastet e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme, të cilat reflektojnë situata serioze përsa i përket rrezikut aktual dhe potencial ndaj punëtorëve dhe publikut.

10.1.6. Autoriteti kompetent duhet t'u kërkojë punëdhënësve të realizojnë hetime ndaj aksidenteve specifike në punë, sëmundjeve profesionale, aksidenteve gjatë lëvizjes, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme, dhe të raportojnë lidhur me veprimin e ndërmarrë për të parandaluar një përsëritje të tyre.

10.1.7. Autoriteti kompetent duhet t'u kërkojë punëdhënësve që t'i asistojë këta të fundit gjatë realizimit të hetimit.

10.2. Në nivelin e ndërmarrjes

10.2.1. Punëdhënësi duhet të hetojë të gjithë aksidentet në punë të raportuar, sëmundjet profesionale, ngjarjet dhe incidentet e rrezikshme.

10.2.2. Punëdhënësi duhet të sigurojë që personi kompetent, siç është specifikuar nga ana e autoritetit kompetent, është identifikuar brenda ndërmarrjes për të kryer hetime të plota të aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe ngjarjeve të rrezikshme.

10.2.3. Kur punëdhënësit i mungon ekspertiza e nevojshme brenda ndërmarrjes për të realizuar hetimin e plotë, ai duhet të kërkojë nga jashtë ndërmarrjes asistencën e një personi me përgatitjen e nevojshme si ekspert.

10.2.4. Punëdhënësi duhet të marrë masa që vendi ku ndodhi një aksident në punë ose një ngjarje të rrezikshme, të mbahet i pa prekur përpara fillimit të hetimit, me përjashtim të rasteve kur ka kërkesa për ndihmë të parë ose për të parandaluar rrezikimin e mëtejshëm të personave.

10.2.5. Në rastin kur për arsye të ndihmës së parë, ose për të parandaluar rrezikimin e mëtejshëm të personave, është e nevojshme të preket vendngjarja përpara fillimit të hetimit, punëdhënësi duhet të marrë masa që, përpara çdo ndërhyrje, një person kompetent të bëjë regjistrimin e të dhënave të vendit të ngjarjes, përfshirë kur është e nevojshme, fotografimet, vizatimet dhe marrjen e identiteteve të dëshmitarëve.

10.2.6. Punëdhënësi duhet të sigurojë që hetimet e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe ngjarjeve të rrezikshme, me aq sa është e mundur, duhet të:

- (a) sqarojnë se çfarë ndodhi;
- (b) përcaktojnë shkaqet e asaj që ndodhi; dhe
- (c) identifikojnë masat e nevojshme për të parandaluar një përsëritje.

10.2.7. Punëdhënësi duhet të sigurojë që udhëzimet për një hetim të menjëhershëm të aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme të raportuara, janë gati në ndërmarrje.

10.2.8. Punëdhënësi duhet të bëjë të mundur që raporti i kërkuar sipas paragrafit 10.1.6 të këtij kodi, t'i dërgohet autoritetit kompetent nëpërmjet mjeteve praktikisht më të shpejtë.

10.2.9. Punëdhënësi duhet t'i vërë përfundimet e hetimeve në dispozicion të punëtorëve dhe të përfaqësuesve të tyre, me qëllim që të parandalojë ngjarje të njëjta, dhe që ata të mund ta asistojnë punëdhënësin në zbatimin më efektiv të politikës së tij mbi sigurinë dhe shëndetin në punë.

10.3. Punëtorët dhe hetimi i aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme

10.3.1. Kur punëdhënësi heton sipas këtij kodi një aksident në punë, sëmundje profesionale, aksident gjatë lëvizjes ose ngjarje të rrezikshme, përfaqësuesit e punëtorëve duhet të kenë të drejtën, mjetet dhe kohën e nevojëshme, pa humbur të drejtën e pagës, të marrin pjesë në hetime të tilla.

10.3.2. Punëtorët, gjatë punës së tyre, duhet të asistojnë punëdhënësin dhe personat që veprojnë në emër të tij, në hetimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, ngjarjeve dhe incidenteve të rrezikshme.

Literatura

Komisioni i Komunitetit European (Eurostat):

Metodologjia për harmonizimin e statistikave Europiane të aksidenteve në punë
(*Methodology for the harmonization of European occupational accident statistics*)
(Luksemburg, 1992).

Zyra Ndërkombëtare e Punës (ILO): Rezolutë mbi statistikën e dëmtimeve në punë.
Konferenca e Dhjetë Ndërkombëtare e Staticjenëve të Punës, Gjenevë, Tetor
1962.

—: Rezoluta mbi statistikën e dëmtimeve në punë. Konferenca e Trembëdhjetë
Ndërkombëtare e Staticjenëve të Punës, Gjenevë, Tetor 1982.

—: Rezoluta mbi Klasifikimin Ndërkombëtar të Statusit të Punësimit (ICSE).
Konferenca e Pesëmbëdhjetë Ndërkombëtare e Staticjenëve të Punës, Gjenevë,
Janar 1993.

—: Një sistem i statistikave bazë periodike të dëmtimeve në punë. Mbledhja e
Ekspertëve të Statistikave mbi Dëmtimet në Punë, Gjenevë, Janar 1980.

—: *Klasifikimi Standart Ndërkombëtar i Profesioneve : ISCO-88* (Gjenevë, 1990).

Shoqata Ndërkombëtare e Sigurimit Shoqëror (ISSA): *Roli i statistikave mbi aksidentet
në parandalimin e aksidenteve*, Asamblea e Përgjithshme e XIV-të, Akapulko, Meksikë,
Nëntor - Dhjetor 1992.

Kombet e Bashkuara: *Klasifikimi Ndërkombëtar Standart Industrial i të gjithë
Aktiviteteve Ekonomike—(ISIC)—(rishikimi i tretë)*, Revistat Statistikore, Seritë M, Nr.
4, Rev. 3 (Nju Jork, 1990).

Konventat dhe Rekomandimet ndërkombëtare përkatëse të punës.

Konventat

<i>Nr.</i>	<i>Titulli</i>
81	Inspektimi i Punës, 1947
121	Përfitimet e Dëmtimeve në Punë, 1964 (me Katalogun e I-rë, Lista e sëmundjeve profesionale - ndryshuar më 1980)
129	Inspektimi i Punës (Bujqësia), 1969
134	Parandalimi i Aksidenteve (Detarët), 1970
135	Përfaqësuesit e Punëtorëve, 1971
155	Siguria dhe Shëndeti në Punë, 1981
160	Statistikat e Punës, 1985
161	Shërbimet e Shëndetit në Punë, 1985

Rekomandimet

<i>Nr.</i>	<i>Titulli</i>
81	Inspektimi i Punës, 1947
121	Përfitimet e Dëmtimeve në Punë, 1964
133	Inspektimi Bujqësor (Bujqësia), 1969
142	Parandalimi i Aksidenteve (Detarët), 1970
143	Përfaqësuesit e Punëtorëve, 1971
164	Siguria dhe Shëndeti në Punë, 1981
170	Statistikat e Punës, 1985
171	Shërbimet e Shëndetit në Punë, 1985

Shtojca A: Katalogu i I-rë: Lista e sëmundjeve profesionale (ndryshuar më 1980)¹

Sëmundjet profesionale	Puna që kushtëzon ekspozimin ndaj rrezikut ²
1. Pneumokonioza e shkaktuar prej pluhurit mineral sklerogjenik (silikoza, anthrako-silikoza, asbesti) dhe siliko-tuberkulozi, me kushtin që silikoza është një faktor esencial në shkaktimin e paaftësisë ose të vdekjes	Të gjithë punët që kushtëzojnë ekspozimin tek rreziku përkatës
2. Sëmundjet bronkopneumonare të shkaktuara nga pluhuri i metaleve të rënda	-“-
3. Sëmundjet bronkopneumonare të shkaktuara nga pluhuri i pambukut (byssinosis) ose nga ai i lirit apo kërpit.	-“-
4. Astma profesionale, shkaktuar nga materiale ndjeshmëri-shkaktues ose gërryes, të dy të njohur për këtë çështje dhe karakteristik të procesit të punës	Të gjithë punët që kushtëzojnë ekspozimin tek rreziku përkatës
5. Njolla të jashtëme alergjike dhe pasojat e tyre, të shkaktuara prej thithjes së pluhurave organikë, siç është përshkruar nga legjislacioni kombëtar	-“-
6. Sëmundje të shkaktuara prej beriliumit ose komponimeve të tij toksikë	-“-
7. Sëmundje të shkaktuara prej kadmiumit ose komponimeve të tij toksikë	-“-
8. Sëmundje të shkaktuara prej fosforit ose komponimeve të tij toksikë	-“-

¹ Katalogu i I-rë i Konventës mbi Përfitimet e Dëmtimeve në Punë, 1964 (Nr. 121).

² Gjatë zbatimit të këtij Katalogu, kur është e përshtatshme, duhet të merren në konsideratë shkalla dhe tipi i ekspozimit.

9.	Sëmundje të shkaktuara prej kromit ose komponimeve të tij toksikë	-“-
10.	Sëmundje të shkaktuara prej manganezit ose komponimeve të tij toksikë	-“-
11.	Sëmundje të shkaktuara prej arsenikut ose komponimeve të tij toksikë	-“-
12.	Sëmundje të shkaktuara prej mërkurit ose komponimeve të tij toksikë	Të gjithë punët që kushtëzojnë ekspozimin tek rreziku përkatës
13.	Sëmundje të shkaktuara prej plumbit ose komponimeve të tij toksikë	-“-
14.	Sëmundje të shkaktuara prej fluorit ose komponimeve të tij toksikë	-“-
15.	Sëmundje të shkaktuara prej dysulfatit të karbonit	-“-
16.	Sëmundje të shkaktuara prej derivateve halogjene toksike të hidrokarbureve alifatikë ose aromatikë	-“-
17.	Sëmundje të shkaktuara prej benxenit ose homologëve të tij toksikë	-“-
18.	Sëmundje të shkaktuara prej nitro dhe aminoderivateve të benxenit ose të substancave homologe	-“-
19.	Sëmundje të shkaktuara prej nitroglicerinës ose komponimeve të tjera të acidit nitrik	-“-
20.	Sëmundje të shkaktuara prej alkooleve, alkooleve dihidrike ose prej ketoneve	Të gjithë punët që kushtëzojnë ekspozimin tek rreziku përkatës
21.	Sëmundje të shkaktuara prej asfiksuesve: monoksidi i karbonit, cianidi i hidrogjenit ose derivatet e tij toksikë, sulfiti i hidrogjenit	-“-

22.	Dëmtimi i të dëgjuarit i shkaktuar prej zhurmës	-“-
23.	Sëmundje të shkaktuara prej vibracioneve (çrregullime të muskujve, tendinave, kockave, kyçeve, enëve periferike të gjakut ose nervave periferikë)	-“-
24.	Sëmundje e shkaktuar prej punës në ajër të kompresuar	-“-
25.	Sëmundje të shkaktuara prej rrezatimeve të jonizuara	Të gjithë punët që kushtëzojnë ekspozimin ndaj veprimit të rrezatimeve të jonizuara
26.	Sëmundje të lëkurës të shkaktuara prej elementëve fizikë, kimikë ose biologjikë, të përfshirë në tituj të tjerë	Të gjithë punët që kushtëzojnë ekspozimin tek rreziku përkatës
27.	Kancer epithelomatous primar i lëkurës i shkaktuar prej katranit, rrëshirës, bitumit, vajit mineral, antracenit, ose prej komponimeve, produkteve apo mbetjeve të këtyre substancave	Të gjithë punët që kushtëzojnë ekspozimin tek rreziku përkatës
28.	Kanceri i mushkërisë ose mesotheliomasi i shkaktuar nga asbesti	-“-
29.	Sëmundje infektive ose parazitike në një profesion ku ka rrezik të veçantë ndotje	<p>(a) Shëndeti ose puna laboratorike</p> <p>(b) Puna në veterinari</p> <p>(c) Puna për të mbajtur bagëtitë, trupat e therur të bagëtive (kufomat), pjesë të kufomave të tilla, ose mallra të cilët mund të kenë qënë të ndotur prej bagëtive, kufomave të bagëtive, ose pjesëve të këtyre kufomave</p>

Shtojca B: Lista e propozuar e sëmundjeve profesionale¹

1. Sëmundjet e shkaktuara prej agjentëve

1.1. Sëmundjet e shkaktuara prej agjentëve kimikë

- 1.1.1. Sëmundjet e shkaktuara prej beriliumit ose komponimeve të tij toksike
- 1.1.2. Sëmundjet e shkaktuara prej kadmiumit ose komponimeve të tij toksike
- 1.1.3. Sëmundjet e shkaktuara prej fosforit ose komponimeve të tij toksike
- 1.1.4. Sëmundjet e shkaktuara prej kromit ose komponimeve të tij toksike
- 1.1.5. Sëmundjet e shkaktuara prej manganezit ose komponimeve të tij toksike
- 1.1.6. Sëmundjet e shkaktuara prej arsenikut ose komponimeve të tij toksike
- 1.1.7. Sëmundjet e shkaktuara prej mërkurit ose komponimeve të tij toksike
- 1.1.8. Sëmundjet e shkaktuara prej plumbit ose komponimeve të tij toksike
- 1.1.9. Sëmundjet e shkaktuara prej fluorit ose komponimeve të tij toksike
- 1.1.10. Sëmundjet e shkaktuara prej dysulfatit të karbonit
- 1.1.11. Sëmundjet e shkaktuara prej derivateve halogjenë toksikë tëhidrokarbureve alifatikë ose aromatikë
- 1.1.12. Sëmundjet e shkaktuara prej benzenit ose homologëve të tij toksikë
- 1.1.13. Sëmundjet e shkaktuara prej nitro dhe aminoderivateve toksikë të benzenit ose të homologëve të tij
- 1.1.14. Sëmundjet e shkaktuara prej nitroglicerinës ose komponimeve të tjera të acidit nitrik
- 1.1.15. Sëmundjet e shkaktuara prej alkooleve, alkooleve dihidrike dhe ketoneve
- 1.1.16. Sëmundjet e shkaktuara prej asfiksantëve: monoksidi i karbonit, cianidi I hidrogjenit ose derivatet e tij toksikë, sulfiti i hidrogjenit
- 1.1.17. Sëmundjet e shkaktuara prej akrilonitrilit
- 1.1.18. Sëmundjet e shkaktuara prej oksideve të nitrogjenit
- 1.1.19. Sëmundjet e shkaktuara prej vanadiumit ose komponimeve të tij toksike
- 1.1.20. Sëmundjet e shkaktuara prej antimonit ose komponimeve të tij toksike
- 1.1.21. Sëmundjet e shkaktuara prej heksanit
- 1.1.22. Sëmundjet e dhëmbëve si pasojë e acideve minerale
- 1.1.23. Sëmundjet si pasojë e agjentëve farmaceutikë
- 1.1.24. Sëmundjet si pasojë e taliumit ose e komponimeve të tij

¹ Lista e sëmundjeve profesionale siç është propozuar nga Konsultimi Informal lidhur me Rishikimin e Listës së Sëmundjeve Profesionale, bashkangjitur Konventës mbi Përfitimet e Dëmtimeve në Punë, 1964 (Nr. 121), Gjenevë, 9-12 Dhjetor 1991.

- 1.1.25. Sëmundjet si pasojë e oksmiumit ose e komponimeve të tij
- 1.1.26. Sëmundjet si pasojë e seleniumit ose e komponimeve të tij
- 1.1.27. Sëmundjet si pasojë e bakrit ose e komponimeve të tij
- 1.1.28. Sëmundjet si pasojë e kallajit ose e komponimeve të tij
- 1.1.29. Sëmundjet si pasojë e zinkut ose e komponimeve të tij
- 1.1.30. Sëmundjet si pasojë e ozonit, fozgenit
- 1.1.31. Sëmundjet si pasojë e gërryesve: benzokinoni dhe gërryes të tjerë të korneas
- 1.1.32. Sëmundjet e shkaktuara prej çdo agjenti tjetër kimik, i papërmendur në pikat parakaluese 1.1.1 deri tek 1.1.31, ku është vendosur lidhja midis ekspozimit të punëtorit ndaj këtyre agjentëve kimikë dhe sëmundjeve të shkaktuara.

1.2. Sëmundjet e shkaktuara prej agjentëve fizikë

- 1.2.1. Dëmtim i dëgjimit i shkaktuar prej zhurmës
- 1.2.2. Sëmundjet e shkaktuara prej vibrimit (çrregullime të muskujve, tendinave, kockave, kyçeve, enëve periferike të gjakut dhe nervave periferikë)
- 1.2.3. Sëmundjet e shkaktuara prej punës në ajër të kompresuar
- 1.2.4. Sëmundjet e shkaktuara prej rrezatimeve të jonizuara
- 1.2.5. Sëmundjet e shkaktuara prej rrezatimit të të nxehtit
- 1.2.6. Sëmundjet e shkaktuara prej rrezatimit ultraviolet
- 1.2.7. Sëmundjet si pasojë e temperaturës ekstreme (psh, goditja e diellit, ngrirjet e pjesëve të trupit)
- 1.2.8. Sëmundjet e shkaktuara prej çdo agjenti tjetër fizik, i papërmendur në pikat parakaluese 1.2.1 deri më 1.2.7, ku është vendosur lidhja e drejtpërdrejtë midis ekspozimit të punëtorit ndaj këtyre agjentëve fizikë dhe sëmundjeve të shkaktuara

1.3. Agjentët biologjikë

- 1.3.1. Sëmundjet infektive ose parazitike të hasura në profesionin ku ka rrezik të veçantë për ndotje

2. Sëmundjet sipas sistemeve të përcaktuara të organeve

2.1. Sëmundjet profesionale respiratore

- 2.1.1. Pneumokonioza e shkaktuar prej pluhurit mineral sklerogjenik (silikoza, antrakosilikoza, asbestoza) dhe silikotuberkulozi, me kusht që silikoza të përbëjë një faktor esencial në shkaktimin e pasojës së paaftësisë ose vdekjes
- 2.1.2. Sëmundjet bronkopneumonare të shkaktuara prej pluhurit të metaleve

- të rënda
- 2.1.3. Sëmundjet bronkopneumonale të shkaktuara prej pluhurit të pambukut, lirit apo kërpit
 - 2.1.4. Astma profesionale e shkaktuar prej agjentëve të njohur ndjeshmëri-shkaktues ose gërryes, që janë karakteristikë të procesit të punës
 - 2.1.5. Alveolite alergjikë ekstrinsike të shkaktuara prej thithjes së pluhurave organike, siç është paracaktuar nga legjislacioni kombëtar
 - 2.1.6. Sideroza
 - 2.1.7. Sëmundjet pulmonare bllokuese kronike
 - 2.1.8. Sëmundjet e mushkërisë, si pasojë e aluminit
 - 2.1.9. Çrregullimet e rrugëve të sipërme të frymëmarrjes të shkaktuara prej agjentëve të njohur ndjeshmëri-shkaktues ose gërryes dhe që janë karakteristikë të procesit të punës
 - 2.1.10. Çdo sëmundje tjetër respiratore, e papërmendur në pikat parakaluese 2.1.1 deri tek 2.1.9, e shkaktuar prej një agjenti, ku është vendosur lidhja e drejtpërdrejtë midis ekspozimit të punëtorit ndaj këtij agjenti dhe sëmundjes së shkaktuar

2.2. Sëmundjet profesionale të lëkurës

- 2.2.1. Sëmundjet e lëkurës të shkaktuara prej agjentëve fizikë, kimikë ose biologjikë, të përfshirë në pikat e tjera
- 2.2.2. Vitiligoja profesionale

2.3. Çrregullimet muskularo-skeletore profesionale

- 2.3.1. Sëmundjet muskulo-skeletore të shkaktuara prej aktiviteteve specifike të punës ose prej mjedisit të punës, ku janë të pranishëm faktorë të rrezikut të veçantë

Shembuj të aktiviteteve ose mjediseve të tillë përfshijnë:

- (a) lëvizjen e shpejtë ose të përsëritur
- (b) përpjekjen e forcërishtme
- (c) koncentrimin tej mase të forcës mekanike
- (d) qëndrimet e pavolitshme ose të pa ekuilibruara
- (e) vibracionin

I ftohti lokal ose mjedisor mund ta bëjë të mundshëm rrezikun

3. Kanceri profesional

3.1. Kanceri i shkaktuar nga agjentët në vazhdim

- 3.1.1. Asbesti
- 3.1.2. Benzidina dhe kripërat

- 3.1.3. Eteri bis klorometil (BCME)
- 3.1.4. Kromi dhe komponimet e tij
- 3.1.5. Katranet e qymyrit dhe rrëshirat e tyre; bloza
- 3.1.6. Betanaftilamina
- 3.1.7. Vinil kloridi
- 3.1.8. Benzeni ose homologët e tij toksikë
- 3.1.9. Nitro dhe amino derivatet toksike të benzenit ose homologët e tij
- 3.1.10. Rrezatimet jonizuese
- 3.1.11. Katrani, rrëshira, bitumi, vaji mineral, antraceni, ose komponimet, produktet apo mbetja e këtyre substancave
- 3.1.12. Emetimet e furrave të koksit
- 3.1.13. Komponimet e nikelit
- 3.1.14. Tymi i drurit
- 3.1.15. Kanceri i shkaktuar prej çdo agjenti tjetër të papërmendur në pikat parakaluese 3.1.1 deri tek 3.1.14, ku është vendosur lidhja e drejtpërdrejtë midis ekspozimit të punëtorit ndaj këtij agjenti dhe kancerit të shkaktuar

4. Të tjerat

- 4.1. Nistagmusi i minatorëve

Shtojca C: Klasifikimi Ndërkombëtar Standart Industrial i të gjithë Aktiviteteve Ekonomike (rishikimi i tretë)¹

Kategoria tabelore A: Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria

- 01 Bujqësia, gjuetia dhe aktivitet e shërbimeve që lidhen me to
- 02 Pylltaria, bërja e trupave drusorë dhe aktivitetet e shërbimeve që lidhen me to

Kategoria tabelore B: Peshkimi

- 05 Peshkimi, funksionimi i basenëve për rritjen e peshqve dhe i fermave të peshkut; aktivitetet e rastësishme të shërbimit për peshkimin

Kategoria tabelore C: Nxjerrja e mineraleve dhe e gurit

- 10 Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve; nxjerrja e torfës
- 11 Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror; aktivitetet e rastësishme të shërbimeve në nxjerrjen e naftës dhe gazit, duke përjashtuar rivelimin e tokës
- 12 Nxjerrja e uraniumit dhe xeherorëve të toriumit
- 13 Nxjerrja e xeherorëve metalorë
- 14 Të tjerat për nxjerrjen e mineraleve dhe të gurit

Kategoria tabelore D: Prodhimi

- 15 Prodhimi i produkteve dhe pijeve ushqimore
- 16 Prodhimi i produkteve të duhanit
- 17 Prodhimi i tekstileve
- 18 Prodhimi i rrobave për veshje; veshja dhe lyerja e gëzofëve
- 19 Regjja dhe veshja e lëkurës; prodhimi i valixheve, çantave, takëmeve të kuajve dhe këpucëve
- 20 Prodhimi i drurit, produkteve të drurit dhe tapës, me përjashtim të mobiljeve; prodhimi i artikujve prej kashte dhe materialeve të gërshetuar
- 21 Prodhimi i letrës dhe produkteve të letrës
- 22 Botimet, printimet dhe riprodhimet e medias së regjistruar

- 23 Prodhimi i koksit, produkteve të naftës së rafinuar dhe karburantit nuklear

¹ Për detaje të plota shih: Kombet e Bashkuara, Revistat Statistikore, Seritë M, Nr. 4, Rev. 3 (Nju York, 1990).

- 24 Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike
- 25 Prodhimi i gomës dhe produkteve plastike
- 26 Prodhimi i produkteve të tjera minerale jo metalike
- 27 Prodhimi i metaleve bazikë
- 28 Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, me përjashtim të makinerive dhe pajisjeve
- 29 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve NEC¹
- 30 Prodhimi i makinerive për zyra, kontabilitet dhe logaritje
- 31 Prodhimi i makinerive dhe aparaturave elektrike NEC¹
- 32 Prodhimi i paisjeve të radios, televizionit dhe komunikimit, si edhe i aparaturave
- 33 Prodhimi i instrumentave mjekësorë, të preçizionit dhe optikë, të orëve të dorës dhe sahatëve
- 34 Prodhimi i makinave me motorr, të trailerve dhe gjysëm trailerve
- 35 Prodhimi i paisjeve të tjera transportuese
- 36 Prodhimi i mobiljeve; prodhimi i NEC¹
- 37 Riciklimi

Kategoria tabelore E: Paisjet e energjisë elektrike, të gazit dhe ujit

- 40 Paisjet e elektrikut, gazit, avullit dhe ujit të ngrohtë
- 41 Grumbullimi, pastrimi dhe shpërndarja e ujit

Kategoria tabelore F: Ndërtimi

- 45 Ndërtimi

Kategoria tabelore G: Tregu me shumicë dhe pakicë; riparimi i makinave me motorr, motoçikletave dhe mallrave personale apo të ekonomisë shtëpijake

- 50 Shitja, mirëmbajtja dhe riparimi i makinave me motorr dhe motoçikletave; shitja me pakicë e karburantit të makinave
- 51 Tregu me shumicë dhe tregu me komision, me përjashtim të makinave me motorr dhe motoçikletave
- 52 Tregu me pakicë, me përjashtim të makinave me motorr dhe motoçikletave; riparimi i mallrave personale dhe të ekonomisë shtëpijake

Kategoria tabelore H: Hotelet dhe restorantet

- 55 Hotelet dhe restorantet

¹ Të paklasifikuara gjetkë.

Kategoria tabelore I: Transporti, magazinimi dhe komunikacionet

- 60 Transporti tokësor; transporti nëpërmjet tubave (për shembull, naftësjellësit)
- 61 Transporti ujor
- 62 Transporti ajror
- 63 Aktivitetet mbështetëse dhe ndihmëse të transportit; aktivitetet e agjensive të udhëtimeve
- 64 Posta dhe telekomunikacionet

Kategoria tabelore J: Ndërmjetësimi financiar

- 65 Ndërmjetësimi financiar, me përjashtim të financimeve të sigurimeve dhe pensioneve
- 66 Financimi i sigurimeve dhe pensioneve, me përjashtim të sigurimit shoqëror të detyrueshëm
- 67 Aktivitetet ndihmëse tek ndërmjetësimi financiar

Kategoria tabelore K: Pasuria e patundëshme, aktivitetet e qerasë dhe biznesit

- 70 Aktivitetet e pasurisë së patundëshme
- 71 Marrja me qera e makinerive dhe pajisjeve pa drejtues dhe e mallrave personale dhe të ekonomisë shtëpijake
- 72 Kompjuteri dhe aktivitetet që lidhen me të
- 73 Kërkimi dhe zhvillimi
- 74 Aktivitetet e tjera të biznesit

Kategoria tabelore L: Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurimi i detyrueshëm shoqëror

- 75 Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurimi i detyrueshëm shoqëror

Kategoria tabelore M: Arsimi

- 80 Arsimi

Kategoria tabelore N: Shëndeti dhe puna sociale

- 85 Shëndeti dhe puna sociale

Kategoria tabelore 0: Aktivitetet e tjera të shërbimit komunitar, sociale dhe personale

- 90 Aktivitetet e ujrave të zeza dhe plehrave, të sanitetit dhe të ngjajshmet me to
- 91 Aktivitetet dhe organizatat me antarësi NEC
- 92 Aktivitetet çlodhëse, kulturore dhe sportive
- 93 Aktivitetet e tjera të shërbimit

Kategoria tabelore P: Ekonomia shtëpijake private me persona të punësuar

- 95 Ekonomia shtëpijake private me persona të punësuar

Kategoria tabelore Q: Organizatat dhe organet jashtë territoriale

- 99 Organizatat dhe organet jashtë-territoriale

Shtojca D: Klasifikimi Ndërkombëtar Standart i Profesioneve (ISCO-88), grupet parësorë, parësorë të shkallës së dytë dhe dytësorë.

Grupi parësor 1: Ligjvënësit, zyrtarët dhe menaxherët e lartë

- 11 Ligjvënësit dhe zyrtarët e lartë
 - 111 Ligjvënësit
 - 112 Zyrtarët e lartë shtetërorë
 - 113 Shefat tradicionalë dhe të parët e fshatrave
 - 114 Zyrtarët e lartë të organizatave të interesit të veçantë

- 12 Menaxherët e korporatave¹
 - 121 Drejtorët dhe shefat zbatues
 - 122 Menaxherët e departamenteve të prodhimit dhe të operacioneve
 - 123 Menaxherët e tjerë të departamenteve

- 13 Menaxherët e përgjithshëm²
 - 131 Menaxherët e përgjithshëm

Grupi parësor 2: Profesionistët

- 21 Profesionistët e shkencave fizike, matematikore dhe inxhinjerike
 - 211 Fizikanët, kimistët dhe profesionistët e afërm me ta
 - 212 Matematicienët, stacionienët dhe profesionistët e ngjajshëm
 - 213 Profesionistët e kompjuterave
 - 214 Arqitektët, inxhinjerët dhe profesionistët e ngjajshëm

- 22 Profesionistët e shkencës së jetës dhe shëndetit
 - 221 Profesionistët e shkencës së jetës
 - 222 Profesionistët e shëndetit (me përjashtim të infermjerisë)
 - 223 Profesionistët e infermjerisë dhe të shtëpive të lindjes

- 23 Profesionistët mësim-dhënës

¹ Ky nën-grup i rëndësishëm synon të përfshijë persona si drejtor, shefa zbatues ose menaxherë të specializuar, të cilët drejtojnë ndërmarrje që kërkojnë tre ose më shumë menaxherë.

² Ky nën-grup i rëndësishëm synon të përfshijë persona që menaxhojnë ndërmarrjet në emër të vetvetes, ose në emër të pronarit, me një farë ndihme dhe asistence jo menaxheriale prej jo më shumë se e një menaxheri.

- 231 Profesionistët mësim-dhënës të kolegjit, universitetit dhe shkollës së mesme
- 232 Profesionistët mësim-dhënës të arsimit të mesëm
- 233 Profesionistët mësim-dhënës të arsimit fillor dhe para shkollor
- 234 Profesionistët mësim-dhënës të arsimit të veçantë
- 235 Profesionistët e tjerë mësim-dhënës

- 24 Profesionistët e tjerë
 - 241 Profesionistët e biznesit
 - 242 Profesionistët ligjorë
 - 243 Arkivistët, bibliotekarët dhe profesionistët e fushës së informacionit që lidhen me ta
 - 244 Shkencat shoqërore dhe profesionistët përkatës
 - 245 Shkrimtarët dhe artistët krijues ose egzekutues
 - 246 Profesionistët fetarë

Grupi parësor 3: Teknicjenët dhe profesionistët e asocjuar

- 31 Profesionistët e asocjuar të shkencës fizike dhe inxhinjerisë
 - 311 Teknicjenët e shkencës fizike dhe inxhinjerisë
 - 312 Profesionistët e asocjuar të kompjuterave
 - 313 Operatorët e paisjeve optike dhe elektronike
 - 314 Kontrollorët dhe teknikët e anijeve dhe avjonëve
 - 315 Inspektorët e sigurisë dhe cilësisë

- 32 Profesionistët e asocjuar të shkencës jetësore dhe shëndetit
 - 321 Teknicjenët e shkencës jetësore dhe profesionistët e ngjajshëm
 - 322 Profesionistët e asocjuar të shëndetit modern (me përjashtim të infirmjerisë)
 - 323 Profesionistët e asocjuar të infirmjerisë dhe shtëpive të lindjes
 - 324 Mjekët e mjekësisë tradicionale dhe shëruesit me anë të lutjeve

- 33 Profesionistët e asocjuar mësim-dhënës
 - 331 Profesionistët e asocjuar mësim-dhënës të arsimit fillor
 - 332 Profesionistët e asocjuar mësim-dhënës të arsimit para shkollor
 - 333 Profesionistët e asocjuar mësim-dhënës të arsimit special
 - 334 Profesionistët e tjerë të asocjuar mësim-dhënës

- 34 Profesionistët e tjerë të asocjuar
 - 341 Profesionistët e asocjuar të financës dhe shitjeve
 - 342 Agjentët e shërbimeve të biznesit dhe komisionerët tregëtarë
 - 343 Profesionistët e asocjuar administrativë
 - 344 Doganat, taksat dhe profesionistët e asocjuar përkatës qeveritarë
 - 345 Inspektorët e policisë dhe detektivët
 - 346 Profesionistët e asocjuar të punës sociale

- 347 Profesionistët e asocjuar artistikë, të zbavitjes dhe sportive
- 348 Profesionistët e asocjuar fetarë

Grupi parësor 4: Nëpunësit

- 41 Nëpunësit e zyrave
 - 411 Sekretaret dhe nëpunësit që shtypin materiale
 - 412 Nëpunësit numerikë
 - 413 Nëpunësit materialo-regjistrues dhe të transportit
 - 414 Biblioteka, posta dhe nëpunësit përkatës
 - 419 Nëpunësit e tjerë të zyrave
- 42 Nëpunësit e shërbimit të klientëve
 - 421 Arkëtarët, arkëtarët e bankës dhe nëpunësit e ngjajshëm me ta
 - 422 Nëpunësit e informimit të klientëve

Grupi parësor 5: Punëtorët e shërbimit dhe punëtorët e dyqaneve dhe tregjeve të shitjes

- 51 Punëtorët e shërbimeve personale dhe mbrojtëse
 - 511 Shoqëruesit e udhëtimit dhe punëtorët e ngjajshëm
 - 512 Punëtorët e shërbimeve brenda shtëpive dhe në restorante
 - 513 Kujdesi personal dhe punëtorët përkatës
 - 514 Punëtorët e tjerë të shërbimit personal
 - 515 Astrologët, treguesit e fatit dhe punëtorët e ngjajshëm me ta
 - 516 Punëtorët e shërbimeve të mbrojtjes
- 52 Modelet, shitësat dhe paraqitësat e mallit
 - 521 Modelet e modës dhe të tjerët
 - 522 Shitësat e dyqanit dhe paraqitësat e mallit
 - 523 Shitësat e tezgave dhe tregu

Grupi parësor 6: Punëtorët e kualifikuar të bujqësisë dhe peshkimit

- 61 Punëtorët e kualifikuar të bujqësisë dhe peshkimit të orientuar nga tregu
 - 611 Kopshtarët e tregut dhe rritësit e prodhimeve
 - 612 Rritësit e bagëtive të orientuar nga tregu dhe punëtorët e ngjajshëm
 - 613 Rritësit e bagëtive dhe prodhuesit e prodhimeve të orientuara nga tregu
 - 614 Pylltaria dhe punëtorët përkatës

- 615 Punëtorët e peshkimit, gjuetarët dhe ngrehësit e grackave
- 62 Punëtorët e bujqësisë që prodhon mjete jetese dhe ata të peshkimit
 - 621 Punëtorët e bujqësisë që prodhon mjete jetese dhe ata të peshkimit

Grupi parësor 7: Zanatet dhe punëtorët zanatçinj përkatës

- 71 Punëtorët zanatçinj të nxjerrjes dhe ndërtimit
 - 711 Minatorët, fitil-ndezësit, prerësit e gurit dhe gdhendësit
 - 712 Strukturat e ndërtesave dhe zanatçinjtë përkatës
 - 713 Punëtorët që e përfundojnë ndërtesën dhe zanatçinjtë e ngjajshëm
 - 714 Bojaxhinjtë, pastruesit e strukturave të ndërtesave dhe zanatçinjtë e ngjajshëm
- 72 Metalet, makineritë dhe zanatçinjtë përkatës
 - 721 Derdhësit e metaleve, saldatorët, punëtorët e punimit të fletëve të metaleve, përgatitësit e strukturave metalike dhe zanatçinjtë e ngjajshëm
 - 722 Farkëtarët, prodhuesit e veglave dhe zanatçinjtë e ngjajshëm
 - 723 Mekanikët e makinave dhe montatorët
 - 724 Mekanikët e paisjeve elektrike, elektronike dhe montatorët
- 73 Preçizioni, puna e dorës, shtypshkimi dhe zanatçinjtë përkatës
 - 731 Punëtorët e preçizionit në metale dhe materialet përkatëse
 - 732 Punuesit e baltës, prodhuesit e xhamit dhe zanatçinjtë e ngjajshëm
 - 733 Punëtorët e punës me dorë në dru, tekstile, lëkurë dhe materialet përkatëse
 - 734 Shtypshkrimi dhe zanatçinjtë përkatës
- 74 Zejet e tjera dhe zanatçinjtë përkatës
 - 741 Përpunimi i ushqimeve dhe zanatçinjtë përkatës
 - 742 Trajtuesit e drurit, mobilierët dhe zanatçinjtë e ngjajshëm
 - 743 Tekstili, veshmbathjet dhe zanatçinjtë përkatës
 - 744 Zanatçinjtë e shajakut, të lëkurës dhe këpucëbërësit

Grupi parësor 8: Operatorët dhe montatorët e impianteve dhe makinave

- 81 Impiantet e stacionuar dhe operatorët përkatës
 - 811 Operatorët e impianteve të nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve
 - 812 Operatorët e impianteve të përpunimit të metaleve

- 813 Xhami, qeramika dhe operatorët përkatës të impiantit
- 814 Operatorët e impianteve të përpunimit të drurit dhe prodhimit të letrës
- 815 Operatorët e impianteve të përpunimit kimik
- 816 Prodhimi i energjisë dhe operatorët përkatës të impiantit
- 817 Linja automatike e montimit dhe operatorët e robotëve industrialë

- 82 Operatorët dhe montatorët e makinave
 - 821 Operatorët e makinave për produkte metalesh dhe mineralesh
 - 822 Operatorët e makinave për produkte kimike
 - 823 Operatorët e makinave për produkte gome dhe plastike
 - 824 Operatorët e makinave për produkte druri
 - 825 Operatorët e makinave për shtypshkrime, lidhje librash dhe prodhime letre
 - 826 Operatorët e makinave për produkte tekstili, gëzofi dhe lëkure
 - 827 Operatorët e makinave për produkte ushqimore dhe të ngjajshme me to
 - 828 Montatorët
 - 829 Operatorët dhe montatorët e tjerë të makinave

- 83 Shoferët dhe operatorët e impianteve lëvizës
 - 831 Shoferët e lokomotivave dhe punëtorët e ngjajshëm
 - 832 Shoferët e automobilave
 - 833 Operatorët e impiantit lëvizës bujqësor dhe të impianteve të tjerë
 - 834 Ekipazhet e anijeve dhe punëtorët e ngjajshëm

Grupi parësor 9: Profesionet e thjeshta

- 91 Profesionet thjeshta e të shitjes dhe shërbimeve
 - 911 Shitësit e rrugëve dhe punëtorët e ngjajshëm
 - 912 Llustrimi i këpucëve dhe profesionet e tjerë të thjeshtë të shërbimeve në rrugë
 - 913 Punët e shtëpisë dhe ndihmësit, pastruesit dhe rroba larësit përkatës
 - 914 Kujdestarët e godinave, dritaret dhe pastruesit përkatës
 - 915 Lajmëtarët, portierët dhe punëtorët e ngjajshëm
 - 916 Grumbulluesit e mbeturinave dhe punëtorët e ngjajshëm

- 92 Punëtorët e bujqësisë, të peshkimit dhe puntorët e ngjajshëm
 - 921 Punëtorët e bujqësisë, të peshkimit dhe puntorët e ngjajshëm

- 93 Punëtorët e minjerave, të ndërtimit, prodhimit dhe transportit
 - 931 Punëtorët e minjerave dhe ndërtimit
 - 932 Punëtorët e prodhimit

933 Punëtorët e transportit dhe mbajtësit e ngarkesave

Grupi parësor 0: Forcat e armatosura

- 01 Forcat e armatosura
 - 011 Forcat e armatosura

Shtojca E: Klasifikimi Ndërkombëtar i Statusit në Punësim (ICSE)¹

I. Emri dhe baza konceptuale për klasifikimin

1. Klasifikimi i statusit në punësim, siç tregohet në seksionin e II-të të kësaj rezolute, është përcaktuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Statusit në Punësim (ICSE-93). Përkufizimet e grupit janë dhënë në seksionin e III-të, ndërsa trajtimi statistikor i grupeve të veçantë është specifikuar në seksionin e IV-t.

2. Klasifikimi Ndërkombëtar i Statusit në Punësim (ICSE) klasifikon punët që bëhen nga personat në një kohë të caktuar. Puna klasifikohet duke mbajtur në konsideratë tipin e kontratës të hapur (eksplicite) ose të mbyllur (implicite) të punësimit të personit, me persona ose organizata të tjera. Kriteret bazë të përdorur për përcaktimin e grupeve të klasifikimit janë tipi i rrezikut ekonomik, një element i të cilit është forca e lidhjes midis personit dhe punës, dhe tipi i autoritetit mbi ndërmarrjet dhe mbi punëtorët e tjerë, që kandidatët për punë kanë ose do të kenë.

3. Klasifikimi Ndërkombëtar i Statusit në Punësim (ICSE-93) i klasifikon personat në sajë të lidhjeve të tyre aktuale ose potenciale me punët, sipas rregullave të vendosura në seksionin e V-të.

II. Grupet e Klasifikimit Ndërkombëtar të Statusit në Punësim (ICSE-93)²

4. Klasifikimi Ndërkombëtar i Statusit në Punësim (ICSE-93) përbëhet prej grupeve në vazhdim, që janë përcaktuar në seksionin e III-të:

- (1) të punësuarit;
ndërmjet të cilëve vendet e ndryshme mund të kenë nevojë dhe të jenë në gjendje të dallojnë “të punësuarit me kontrata të qëndrueshme” (duke përfshirë “të punësuarit e rregullt”);
- (2) punëdhënësit;
- (3) punëtorët që punojnë për llogari të vet;
- (4) anëtarët e kooperativave të prodhuesve;
- (5) punëtorët kontribues të familjes;
- (6) punëtorët e paklasifikueshëm me status.

¹ Pjesë nga rezoluta lidhur me Klasifikimin Ndërkombëtar të Statusit në Punësim (ICSE). Konferenca e Pesëmbëdhjetë Ndërkombëtare e Statisticjenëve të Punës, Gjenevë, 19-28 Janar 1993.

² Për efekt gjuhësor, titujt dhe përkufizimet e grupeve janë formuluar në një mënyrë që i korrespondon situatës ku çdo person bën vetëm një punë gjatë periudhës referuese. Rregullat për klasifikimin e personave me dy ose më shumë punë, janë dhënë në seksionin e V-të.

III. Përkufizimet e grupit

5. Në Klasifikimin Ndërkombëtar të Statusit në Punësim (ICSE-93), grupet janë përkufizuar duke iu referuar dallimit midis punëve të “punësimit të paguar”, nga njëra anë, dhe punëve të “vet-punësimit”, nga ana tjetër. Grupet janë përkufizuar duke iu referuar një ose më shumë aspekteve të rrezikut ekonomik dhe/ose tipit të autoritetit, të cilin kontrata e hapur ose e mbyllur e punësimit ua jep kandidatëve.

6. *Punët e punësimit të paguar* janë ato punë ku kandidatët e angazhuar mbajnë kontrata punësimi të hapura (të shkruara ose gojore) ose të mbyllura, të cilat u sigurojnë atyre një pagesë bazë që nuk është drejtpërdrejtë e varur nga të ardhurat e njësisë për të cilën ata punojnë (kjo njësi mund të jetë korporatë, institucion jo fitim-prurës, njësi qeveritare ose ekonomi shtëpijake). Disa, ose që të gjitha veglat, paisjet kapitale, sistemet e informimit dhe/ose mjediset e përdorura prej kandidatëve, mund të jenë në pronësi të të tjerëve, dhe kandidatët mund të punojnë nën vëzhgimin e drejtpërdrejtë të udhëzuesve të rreptë të vendosur prej pronarit (pronarëve) ose të personave në punësimin e pronarëve. (Personat në “punët e punësimit të paguar” janë paguar përgjithsisht me rroga dhe paga, por mund të paguhen edhe me komisione nga shitjet, me pjesë qerash, shpërblime ose pagesa në natyrë, si për shembull ushqime, strehim ose trajnim.)

7. *Punët e vet-punësimit* janë ato punë ku pagesa është e varur drejtpërdrejtë prej fitimeve (ose prej mundësisë për fitim) që rrjedhin nga mallrat dhe shërbimet e prodhuara (ku konsumi vetjak konsiderohet si pjesë e fitimeve). Kandidatët marrin vendimet operative që kanë pasoja mbi ndërmarrjen, ose i delegojnë të tilla vendime, duke mbajtur përgjegjësinë për mbarëvajtjen e ndërmarrjes. (Në këtë kontekst “ndërmarrja” përfshin operacionet e një personi.)

8. (1) *Të punësuarit* janë të gjithë ata punëtorë që bëjnë tipin e punës të përkufizuar si “punët e punësimit të paguar” (shih paragrafin 6). *Të punësuarit me kontrata të qëndrueshme* janë ata “të punësuar” që kanë patur dhe vazhdojnë të kenë një kontratë punësimi të hapur (të shkruar ose gojore) ose të mbyllur, apo një sërë kontratash të tilla, me të njëjtin punëdhënës dhe mbi një bazë të vazhdueshme. “Mbi një bazë të vazhdueshme” nënkupton një periudhë punësimi që është më e gjatë se një minimum i specifikuar, i përcaktuar sipas rrethanave kombëtare. (Në rast se në këtë periudhë minimale lejohen ndërprerje, zgjatja e tyre maksimale duhet të përcaktohet gjithashtu sipas rrethanave kombëtare.) *Të punësuarit e rregullt* janë ata “të punësuar me kontrata të qëndrueshme” ndaj të cilëve organizata punësuese është përgjegjëse për pagesën e taksave përkatëse dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe/ose ku marrëdhënia kontraktuale është objekt i legjislacionit kombëtar të punës.

9. (2) *Punëdhënësit* janë ata punëtorë që, duke punuar për llogari të tyre apo me një ose me disa (pak) partnerë, bëjnë tipin e punës të përkufizuar si një “punë vet-punësuese” (shih paragrafin 7) dhe, në këtë cilësi, kanë angazhuar mbi një bazë të vazhdueshme (duke përfshirë periudhën referuese) një ose më shumë persona, për të punuar për ta në bizneset e tyre si “të punësuar” (shih paragrafin 8). Kuptimi i “angazhim mbi një bazë të vazhdueshme” duhet të përcaktohet nga rrethanat kombëtare, në një

mënyrë që është në përputhje me përkufizimin e “të punësuarve me kontrata të qëndrueshme” (shih paragrafin 8). (Partnerët mund ose nuk mund të jenë anëtarë të së njëjtës familje ose ekonomie shtëpijake.)

10. (3) *Punëtorët që punojnë për llogari të vet* janë ata punëtorë që, duke punuar për llogari të vet apo me një ose më shumë partnerë, bëjnë tipin e punës të përkufizuar si një “punë vetpunësuese” (shih paragrafin 7), dhe nuk kanë angazhuar mbi një bazë të qëndrueshme ndonjë “të punësuar” (shih paragrafin 8) për të punuar për ta gjatë periudhës referuese. Duhet vërejtur që gjatë periudhës referuese anëtarët e këtij grupi mund të kenë angazhuar “të punësuar”, me kusht që kjo të jetë mbi një bazë jo të vazhdueshme. (Partnerët mund të jenë ose jo, anëtarë të së njëjtës familje ose ekonomie shtëpijake.)

11. (4) *Anëtarët e kooperativave të prodhuesve* janë ata punëtorë që bëjnë një punë “vetpunësimi” (shih paragrafin 7) në një kooperativë që prodhon mallra dhe shërbime, në të cilën çdo anëtar, mbi baza barazie me anëtarët e tjerë, merr pjesë në përcaktimin e organizimit të prodhimit, të shitjeve dhe/ose punëve të tjera të ndërmarrjes, të investimeve dhe të shpërndarjes së të ardhurave ndërmjet anëtarëve të saj. (Duhet vërejtur që “punëdhënësit” (shih paragrafin 8) e kooperativave të prodhuesve nuk do të klasifikohen në këtë grup.)

12. (5) *Punëtorët kontribues të familjes* janë punëtorët që bëjnë një punë “vetpunësuese” (shih paragrafin 7) në një ndërmarrje të orientuar nga tregu, e drejtuar prej një personi të afërt me ta dhe që jeton në të njëjtën shtëpi, të cilët nuk mund të konsiderohen si partnerë, pasi shkalla e angazhimit të tyre në drejtimin e ndërmarrjes, në kuptimin e kohës së punës apo faktorëve të tjerë për t’u përcaktuar prej rrethanave kombëtare, nuk është në një nivel të krahasueshëm me atë të drejtuesit të ndërmarrjes. (Kur është e zakonshme, në veçanti për personat e rinj, që të punohet pa pagesë në një ndërmarrje ekonomike të drejtuar nga një person i afërm, i cili nuk jeton në të njëjtën shtëpi, kërkesa për “të jetuar në të njëjtën shtëpi” mund të eliminohet.)

13. (6) *Punëtorët e paklasifikueshëm me status* përfshijnë ata për të cilët informacioni përkatës në dispozicion është i pamjaftueshëm dhe/ose që nuk mund të përfshihen në ndonjërin prej kategorive parakaluese.

IV. Trajtimi statistikor i grupeve të veçantë

14. Ky seksion skicon një trajtim të mundshëm statistikor të grupeve të veçantë të punëtorëve. Disa nga grupet përfaqsojnë nën-kategoritë ose papajtueshmëritë e njërës prej kategorive specifike të Klasifikimit Ndërkombëtar të Statusit në Punësim (ICSE-93). Grupe të tjerë mund të kalojnë nëpër dy ose më shumë kategori. Vendet e ndryshme mund të kenë nevojë dhe të jenë në gjëndje të dallojnë një ose më shumë nga grupet, në veçanti grupin (a), dhe gjithashtu mund të krijojnë grupe të tjera, sipas kërkesave kombëtare:

- (a) *Menaxherët-pronarë të ndërmarrjeve të inkuorporuara* janë punëtorët që kanë një punë në ndërmarrjen e inkuorporuar, ku ata: (a) të vetëm, ose së bashku me anëtarët e tjerë të familjeve të tyre apo me një ose disa partnerë, mbajnë kontrollin e pronësisë mbi këtë ndërmarrje; dhe (b) kanë autoritetin të veprojnë në emër të saj përsa i përket kontratave me organizata të tjera, si dhe pranimin dhe pushimin nga puna të personave në “punësimin e paguar” në të njëjtën organizatë, që i nënshtrohen vetëm legjislacionit kombëtar që rregullon çështje të tilla dhe rregullave të vendosura prej bordit të zgjedhur apo të emëruar të organizatës. Përdorues të ndryshëm të tregut të punës, statistikat ekonomike dhe shoqërore, mund të kenë pikpamje të ndryshme përsa i përket faktit që këta punëtorë janë më mirë të klasifikuar në “punësimin e paguar” (shih paragrafin 6) apo në “vet-punësim” (shih paragrafin 7), sepse këta punëtorë e marrin një pjesë të shpërblimit të tyre në një mënyrë të ngjajshme me personat në “punësimin e paguar”, në një kohë që autoriteti i tyre në ndërmarrje dhe përgjegjësia për këtë të fundit, i korrespondon më shumë personave në “vet-punësim”, dhe në veçanti në “punëdhënës”. (Dallo, për shembull, që klasifikimi i tyre si “të punësuar” do të jetë në përputhje me klasifikimin e tyre në “Sistemin e Llogarive Kombëtare”, ndërkohë që ata, për analiza të tregut të punës, mund të jenë të klasifikuar më mirë në “punëdhënësit” apo në “punëtorët që punojnë për llogari të vet”.) Vendet e ndryshme, gjithsesi, duhet që në raport me nevojat e përdoruesve të statistikave që përpilojnë dhe mundësi të tyre për grumbullimin e të dhënave, të përpiqen ta identifikojnë veçmas këtë grup. Kjo do t’i lehtësojë gjithashtu krahasimet ndërkombëtare.
- (b) *Të punësuarit e rregullt me kontrata me afat* janë “të punësuarit e rregullt” (shih paragrafin 8), kontrata e punës e të cilëve specifikon një datë të caktuar përfundimi.
- (c) *Të punësuarit e rregullt me kontrata pa afat* janë “të punësuarit e rregullt” (shih paragrafin 8), që kanë kontrata të cilat mund të përfundohen vetëm për shkaqe të specifikuara, si për shembull, paaftësia, drejtimi mjaftë i keq, apo për arsye ekonomike, sipas legjislacionit ose eksperiencës kombëtare.
- (d) *Punëtorët në punësim të pasigurt* mund të jenë ose: (a) punëtorët, kontrata e punësimit e të cilëve e klasifikon kandidatin si pjesëtar të grupeve të “punëtorëve të rastësishëm” (shih pikën (e)), “punëtorëve afat-shkurtër” (shih pikën (f) ose “punëtorëve sezonalë” (shih pikën (g)); ose (b) punëtorët, kontrata e punësimit e të cilëve i jep mundësi ndërmarrjes apo personit punësues ta përfundojë atë kontratë menjëherë pas njoftimit (njoftim afat-shkurtër) dhe/ose kur ai të ketë dëshirë për ta bërë këtë, në kushtet kur rrethanat specifike duhet të përcaktohen prej legjislacionit dhe eksperiencës kombëtare.
- (e) *Punëtorët e rastësishëm* janë punëtorët që kanë një kontratë punësimi të hapur ose të mbyllur, e cila nuk parashikohet të vazhdojë për më shumë se një periudhë e shkurtër kohe, zgjatja e së cilës do të përcaktohet prej rrethanave kombëtare. Këta punëtorë mund të klasifikohen si të jenë “të punësuar” (shih paragrafin 8) ose

“punëtorë që punojnë për llogari të vet” (shih paragrafin 10), sipas karakteristikave specifike të kontratës së punësimit.

- (f) *Punëtorët në punësimin afat-shkurtër* janë punëtorët që kanë kontrata të hapura ose të mbyllura punësimi (shih paragrafin 6), të cilat parashikohen të zgjasim më shumë se periudha e përdorur për përcaktimin e “punëtorëve të rastësishëm” (shih pikën (e)), por më pak se ajo e përdorur për përcaktimin e “të punësuarve të rregullt” (shih paragrafin 8). Këta punëtorë mund të klasifikohen si “të punësuar” (shih paragrafin 8) ose “punëtorë që punojnë për llogari të vet” (shih paragrafin 10), sipas karakteristikave specifike të kontratës së punësimit.
- (g) *Punëtorët në punësimin sezonal* janë punëtorët që kanë kontrata punësimi të hapura ose të mbyllura, ku përfazimi dhe zgjatja e kontratës ndikohet shumë prej faktorëve sezonalë, si për shembull, ciklit klimaterik, ditëve të pushimit dhe/ose të korrave bujqësore. Këta punëtorë mund të klasifikohen si “të punësuar” (shih paragrafin 8) ose “punëtorë që punojnë për llogari të vet” (shih paragrafin 10), sipas karakteristikave specifike të kontratës së punësimit.
- (h) *Punëtorët e jashtëm* janë punëtorët që: (a) kanë kontratë punësimi të hapur ose të mbyllur, me anë të së cilës ata bien në ujdi të punojnë për një ndërmarrje të veçantë ose t’i ofrojnë një ndërmarrjeje të veçantë një sasi të caktuar mallrash apo shërbimesh, nëpërmjet një marrëveshje apo kontrate paraprake me këtë ndërmarrje; por (b) që vendi i punës i të cilëve, nuk është brenda ndonjërit prej repartëve që përbëjnë këtë ndërmarrje. Këta punëtorë mund të klasifikohen si të ishin në “punësimin e paguar” (shih paragrafin 6) ose në “vet-punësim” (shih paragrafin 7), sipas afateve specifike të kontratës së tyre. Ata mund të klasifikohen si “punëdhënës” në rast se angazhojnë punëtorë të tjerë, sipas kushteve të përshkruara në paragrafin 10.
- (i) *Kontraktorët* janë punëtorë që: (a) janë regjistruar tek autoritetet e taksave (dhe/ose tek organet e tjerë përkatës) si njësi biznesi e veçantë, përgjegjëse për format përkatëse të taksave, dhe/ose që kanë bërë rregullime në mënyrë që organizata e tyre punësuese të mos jetë përgjegjëse për pagesat përkatëse të sigurimeve shoqërore, dhe/ose që marrëdhënia kontraktuale të mos jetë objekt i legjislacionit kombëtar të punës, për shembull i zbatueshëm tek “të punësuarit e rregullt” (shih paragrafin 9); por të cilët (b) kanë kontrata të hapura ose të mbyllura që i korrespondojnë atyre të “punësimit të paguar”. Këta punëtorë mund të klasifikohen në grupin e punës së “vet-punësimit” (shih paragrafin 7), ose në grupin e punës së “punësimit të paguar” (shih paragrafin 6), sipas rrethanave kombëtare.
- (j) Punëtorët që kanë kontrata të hapura ose të mbyllura “punësimi të paguar” (shih paragrafin 6) me një organizatë, por që punojnë në sheshin e punës së një organizate të dytë dhe nën instruksionet e saj, në kushtet kur kjo e fundit i paguan organizatës së parë një shpërblim për shërbimet e tyre, mund të klasifikohen

veçmas prej “të punësuarve” të tjerë dhe në varësi nga fakti nëse organizata e parë është agjensi e përkohshme pune, apo një tip tjetër ndërmarrje.

- (k) *Anëtarët e ekipazhit* janë punëtorët që janë anëtarë të një grupi punëtorësh, të cilët kanë qënë të organizuar si grup sipas kushteve që i korrespondojnë atyre të “punësimit të paguar” dhe ku organizata punësuese ka bërë kontratë vetëm me drejtuesin e ekipazhit, ose me agjentin organizues të ekipazhit, dhe jo me punëtorin individual.
- (l) Vendet e ndryshme mund të kenë nevojë dhe të jenë në gjëndje të klasifikojnë veçmas punëtorët që marrin pjesë në promovimin e punësimit ose në skema trajnimi për punë, qofshin këto publike apo private, lidhur me kushtet e punësimit që i korrespondojnë punëve të “punësimit të paguar”. Ky grup punëtorësh mund të klasifikohet si të *punësuarit e promovimit të punësimit*. Punëtorët që marrin mbështetje nga skema të tilla për ngritjen e bizneseve të tyre, duhet të klasifikohen si të ishin në punën “vet-punësuese” (shih paragrafin 7) si “punëdhënës” (shih paragrafin 9) ose si “punëtor që punon për llogari të vet” (shih paragrafin 10), sipas përshtatshmërisë.
- (m) Sipas rrethanave kombëtare, vendet e ndryshme mund të vendosin për t’i klasifikuar si *nxënës* ose *persona në trajnim* punëtorët që kanë kontrata të hapura ose të mbyllura të “punësimit të paguar”, të cilat specifikojnë që e gjitha ose një pjesë e pagesës së tyre duhet të jetë në formën e trajnimit për tregëti ose për një profesion tjetër. Kur bëjnë përcaktimin veçmas të nxënësve dhe të të punësuarve që marrin trajnim, vendet e ndryshme mund të kenë nevojë dhe të jenë në gjëndje që të bëjnë dallim midis atyre që kanë kontratë zyrtare trajnimi dhe ndjekin një program zyrtar duke kombinuar eksperiencën e punës me mësimin teorik, dhe atyre që nuk e bëjnë këtë.
- (n) *Punëdhënësit e të punësuarve të rregullt* janë ata “punëdhënës” të cilët gjatë periudhës së referuar kanë angazhuar të paktën një person për të punuar për ta dhe në biznesin e tyre, sipas kushteve të hapura ose të mbyllura, të tilla që ky person do të klasifikohet sikur ta kishte punën si një “i punësuar i rregullt”, siç është përcaktuar në paragrafin 8.
- (o) *Shtresa kryesore e punëtorëve që punojnë për llogari të vet* janë ata “punëtorë që punojnë për llogari të vet” (shih paragrafin 10), të cilët punojnë kryesisht për tregun në mënyrë të pavarur prej kushteve specifike të vendosura nga ofruesit e kreditit, të lëndëve të para, etj., ose nga një klient kryesor, dhe që marrin me qera apo kanë në zotërim paisjet e tyre apo mjetet e tjera të prodhimit.
- (p) *Shtresa e punëtorëve që kryejnë shërbime me porosi* janë ata/ato që kanë kontrata të hapura ose të mbyllura me pronarët e mjeteve të caktuara të prodhimit (toka, ndërtesat, makineritë, markat e fabrikës, etj.), mbajtësit e liçencave operationale ose ofruesit e kreditit, të cilët në një masë të rëndësishme përcaktojnë se si është drejtuar biznesi dhe kërkojnë për vehte pagesën e një pjese të rëndësishme të

shitjeve të përgjithshme. “Shtresa e punëtorëve që kryejnë shërbime me porosi ” që angazhojnë “të punësuar” (shih paragrafin 8) mbi një bazë të vazhdueshme, duhet të klasifikohet si “punëdhënësit” (shih paragrafin 9).

- (q) *Ndarësit e prodhimeve* janë punëtorët që kanë një punë “vet-punësuese” (shih paragrafin 7) dhe në këtë cilësi kanë kontrata të hapura ose të mbyllura me zotëruesit e mjeteve të caktuara të prodhimit (toka, ndërtesat, makineritë, etj.) apo me ofruesit e kreditit ose të lëndëve të para, të cilët në një masë të rëndësishme përcaktojnë se si është drejtuar biznesi dhe kërkojnë për vehte pagesën e një pjese të prodhimit të përgjithshëm.
- (r) *Shfrytëzuesit e burimeve komunale* janë punëtorët që kanë një punë “vet-punësimi” (shih paragrafin 7) dhe në këtë cilësi përdorin një burim natyror (për shembull, tokën, zonat e peshkimit, zonat e gjuetisë dhe të grumbullimit), ndaj të cilave nuk ka të drejta individuale pronësie, por për të cilat komuniteti ose Shteti i tyre mund të kenë përgjegjësi të caktuara drejtimi.
- (s) *Punëtorët e jetesës* janë punëtorët që kanë një punë “vet-punësimi” (shih paragrafin 7) dhe në këtë cilësi prodhojnë mallra apo shërbime që konsumohen në pjesën më të madhe nga shtëpia e tyre dhe përbëjnë një bazë të rëndësishme për mjetet e tyre të jetesës.
- (t) Vendet e ndyshme mund të kenë nevojë dhe të jenë në gjëndje që klasifikimin kombëtar sipas statusit në punësim, t’ja bashkangjisin tipit të organizatës ku ata janë të punësuar, në veçanti nëse “të punësuarit” janë punësuar në sektorin privat ose publik, apo nëse organizata punësuese është në zotërimin e pjesshëm të individëve ose organizatave të huaja (“ndërmarrje e përbashkët”), apo tërësisht e zotëruar nga të huajt.

V. Klasifikimi i personave

15. Personat e punësuar mund të klasifikohen sipas statusit në punësim, nëpërmjet rregullave në vazhdim:

- (a) personi që bën vetëm një punë të klasifikueshme gjatë periudhës referuese, duhet të klasifikohet tek grupi i statusit në punësim të asaj pune;
- (b) personi që bën dy ose më shumë punë gjatë periudhës referuese, duhet të klasifikohet tek grupi i statusit në punësim të asaj tërësie prej punësh njëloj të klasifikuar, në të cilën ai ka punuar sasinë më të madhe të orëve, ose e cila ka kushtëzuar të ardhurën më të madhe nga puna gjatë kësaj periudhe (ose e cila mund të japë të ardhurën më të madhe prej punës të realizuar në atë periudhë, në rast se pagesa mund të bëhet vetëm në të ardhshmen).

16. Klasifikimi Ndërkombëtar i Statusit në Punësim (ICSE-93) mund të jetë i zbatueshëm, sipas praktikave dhe rrethanave kombëtare, ndaj personave që kanë pasur

një punë, apo atyre që janë duke kërkuar punë, pavartësisht statusit të tyre të fuqisë punëtore gjatë periudhës referuese. Për të punësuarit, ajo duhet të aplikohet ndaj punës (ose punëve) të bëra gjatë periudhës referuese. Për të papunët, ajo mund të aplikohet ose ndaj një pune të bërë më parë, nqs ka pasur të tillë, ose, sipas praktikave dhe rrethanave kombëtare, ndaj tipit të punës që ata po kërkojnë.

VI. Grumbullimi i të dhënave dhe raportimi ndërkombëtar

17. Të dhënat e nevojshme për klasifikimin e punëve apo personave sipas statusit në grupet e punësimit, duhet të grumbullohen nëpërmjet mënyrave që i korrespondojnë nevojave përshkruese dhe të hollësishme, të cilave u shërben edhe programi individual statistikor, si në lidhje me saktësinë e matjes, ashtu edhe me numrin dhe tipin e grupeve veçmas të identifikuar. Përdorimi i pyetsorëve të përbërë prej vetëm një pyetjeje dhe prej një serie të vogël grupesh të para-koduar, që do të zgjidhen prej përgjigje-dhënësve, ose prej intervistuesve mbi bazën e informacionit të dhënë nga përgjigje-dhënësit, mund të kushtojë diçka më lirë, por normalisht do të rezultojë në një matje më pak të saktë të shpërndarjes së punëve dhe personave sipas statusit përkatës në grupet e punësimit, se sa do të kushtonte përdorimi i pyetjeve të ndryshme me alternativa përgjigjeje, të hartuara për të mundësuar klasifikimin në grupet përkatëse gjatë fazës përpunuese. Konferenca ve në dukje që Zyra e Statistikave e Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ILO), do të japë njohuri se si duhet grumbulluar dhe përpunuar në studimet dhe regjistrimet statistikore, informacioni lidhur me statusin në punësim.

18. Rekomandohet që vendet e ndryshme, me sa të jetë e mundur, të hartojnë procedurat e tyre të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, në mënyrë që ato të jenë në gjëndje të japin vlerësime për ato kategori në vazhdim, që janë të rëndësishme kombëtare:

- (1) të punësuarit;
- (2) punëdhënësit;
- (3) punëtorët që punojnë për llogari të vet;
- (4) anëtarët e kooperativave të prodhuesve;
- (5) punëtorët kontribues të familjes;
- (6) punëtorët e paklasifikueshëm me status.

19. Grupi i Klasifikimit Ndërkombëtar të Statusit në Punësim (ICSE-93) ku klasifikohen “menaxherët-pronarë të ndërmarrjeve të inkuorporuara” (shih paragrafin 14, pika (a)), duhet që të theksohet, ndërsa rreth tyre duhet të jepet informacion i veçantë, kur kjo është e mundur, për të lehtësuar njëherësh analizat e tregut të punës, si edhe krahasimet ndërkombëtare. Vendeve të ndryshme u kërkohet gjithashtu që të identifikojnë për përdoruesit e statistikave të tyre, se cili prej grupeve të veçantë të raportuar përmban të dhëna për personat që janë në çdonjërin prej grupeve jo-veçmas të raportuar.

Shtojca F: Klasifikimi i aksidenteve industriale sipas natyrës së dëmtimit¹

Kjo listë do të përdoret për të klasifikuar vetëm dëmtimet që rezultojnë prej aksidenteve në punë apo aksidenteve gjatë lëvizjes; sëmundjet profesionale, në veçanti, janë të përjashtuara.

10. *Frakturat* (N800-N829)
Përfshin frakturat e thjeshta; frakturat me dëmtime në pjesët e buta të trupit (frakturat komplekse); frakturat me dëmtime tek artikulacionet (përdredhjet, etj.); frakturat me dëmtime të brendëshme ose të nervave.
20. *Përdredhjet* (N830-N839)
Përfshin daljet nga vendi dhe zhvendosjet.
Përjashton përdredhjet e vendit të thyer (10).
25. *Ndrydhjet dhe tërheqjet* (N840-N848)
Përfshin, për aq kohë sa shoqërohet nga një plagë e hapur, thyerjet, shqyerjen dhe skërfitjen e muskujve, të pejzave, ligamenteve dhe kyçeve, si edhe hernian si pasojë e stërmundimit.
30. *Tronditjet dhe dëmtimet e tjera të brendëshme* (N852-N855, N860-N869, N958)
Përfshin, për aq kohë sa shoqërohet nga një frakturë, të gjithë shëmbjet e brendëshme, hemoragjitë, skërfitjet, thyerjet.
Përjashton dëmtimet me frakturë (10).
40. *Prerjet dhe gjymtimet* (N871, N866-N888, N896-N898) Përfshin nxjerrjen traumatike të syrit.
41. *Plagët e tjera* (N850, N870, N872-N879, N880-N885, N890-N895, N900-N908)
Përfshin gërvishjet, plagët e hapura, prerjet, shëmbjet e shoqëruara me plagë, dëmtimet e skalpit, si edhe humbjen e thonjve dhe veshëve; përfshin plagët që shkaktojnë dëmtimet e nervave.
Përjashton prerjet traumatike, gjymtimet; nxerrjen e syrit (40); frakturat komplekse (10); djegiet e shoqëruara me plagë të hapura (60); dëmtimet sipërfaqësore (50).
50. *Dëmtimet sipërfaqësore* (N910-N918)
Përfshin gërvishjet, çjerrjet, fshikjen, pickimet e insekteve jo-helmues, plagët sipërfaqësore; përfshin gjithashtu dëmtimet sipërfaqësore që shkaktojnë trupat e huaj kur futen në sy.

¹ Rezoluta lidhur me statistikat e dëmtimeve në punë. Konferenca e Dhjetë Ndërkombëtare e Staticjenëve të Punës, Gjenevë, 2-12 Tetor 1962.

55. *Shëmbjet dhe shtypjet* (N851, N920-N929)
Përfshin hematrozat, hematomen dhe nxirjen; shëmbjet dhe shtypjet e shoqëruara me dëmtime sipërfaqësore.
Përfshijon tronditjet (30); shëmbjet dhe shtypjet që shoqërohen me fraktura (10); shëmbjet dhe shtypjet me një plagë të hapur (41)
60. *Djegiet* (N940-N949)
Përfshin djegiet prej objekteve të nxehta; prej zjarrit; fluskat e djegies; djegiet prej fërkimit; djegiet nga rrezatimi (infra të kuqe); djegiet kimike (vetëm djegiet e jashtëme); djegiet me plagë të hapur.
Përfshijon djegiet që vinë si pasojë e gëlltitjes së një substance gërryese ose kaustike (70); djegiet prej diellit (80); efektet e ndriçimit (80); djegiet prej energjisë elektrike (82); edhe efektet rrezatues, përveç djegieve (83).
70. *Helmimi i menjëhershëm* (N960-N979)
Përfshin efektet e menjëhershëm të injeksionit, të gëlltitjes, thithjen e substancave toksike, korrozive ose kaustike; pickimet e kafshëve helmuese; asfiksimin prej monoksidit të karbonit ose gazrave të tjerë toksikë. Përfshijon djegiet e jashtëme kimike (60).
80. *Efektet e ekspozimit ndaj motit dhe kushteve që lidhen me të* (N980-N989)
Përfshin efektet e temperaturës së ulët (ngjirjet); efektet e nxehtësisë dhe të qëndrimit të tepërt në diell (goditjet nga nxehtësia, pikën e diellit); barotraumën (efektet që rrjedhin prej lartësisë së madhe, mungesës së presionit); efektet e ndriçimit; traumën e tingullit (humbjen tërësore ose e pjesëshme të të dëgjuarit si një dëmtim i pjesshëm, jo pasojë e ndonjë dëmtimi tjetër).
81. *Asfiksia* (N990-N991)
Përfshin mbytjen, asfiksimin ose mbytjen prej presionit, shtrëngimin ose bllokimin; përfshin gjithashtu asfiksimin prej shtypjes ose pakësimit të oksigjenit në atmosferën rrethuese dhe asfiksimin prej trupave të huaj në rrugën e frymëmarrjes.
Përfshijon asfiksimin prej monoksidit të karbonit ose prej gazrave të tjerë toksikë (70).
82. *Efektet e energjisë elektrike* (N992)
Përfshin zënien nga korenti, goditjen elektrike dhe djegiet si pasojë e korentit elektrik.
Përfshijon djegiet e shkaktuara prej pjesëve të nxehta të paisjeve elektrike (70) dhe efektet e ndriçimit (80).
83. *Efektet e rrezatimeve* (N993)
Përfshin efektet e shkaktuara prej rrezeve X, substancave radioaktive, rrezeve ultraviolette, rrezatimeve jonizues.
Përfshijon djegiet si pasojë e rrezatimeve (60) dhe pikën e diellit (80).

90. *Dëmtimet shumëfishe të natyrave të ndryshme*
Ky grup duhet të përdoret vetëm për rastet kur personi i dëmtuar ka pësuar disa dëmtime të natyrave të ndryshme dhe asnjëri prej dëmtimeve nuk është faktikisht më i rëndë se të tjerët.
Në rastin e dëmtimeve shumëfishe të pësuar në një aksident, ku njëri nga dëmtimet është faktikisht më i rëndë se të tjerët, atëhere ky aksident duhet të klasifikohet në grupin që i korrespondon natyrës së aksidentit faktikisht më të rëndë.
99. *Dëmtimet e tjera dhe të paspecifikuara (N856, N994-N999)*
Ky grup duhet të përdoret vetëm për klasifikimin e dëmtimeve që nuk mund të klasifikohen gjatë, si për shembull, infeksionet.
Përfshin komplikimet e ndryshme dhe të herëshme të traumës dhe reaksioneve patologjike, të cilët duhet të klasifikohen në këtë grup vetëm kur natyra e dëmtimit paraardhës është e panjohur.

Shënim: Numrat prej N800 e deri më N999 i referohen kategorive të Manualit të Klasifikimit Ndërkombëtar Statistikor të Sëmundjeve, Dëmtimeve dhe Shkaqeve të Vdekjes.

Shtojca G: Klasifikimi i aksidenteve industriale sipas vendndodhjes trupore të dëmtimit¹

Ky klasifikim mund të përdoret edhe për klasifikimin e aksidenteve gjatë lëvizjes.

Grupet që kanë të bëjnë me vendndodhjet shumëfishe duhet të përdoren vetëm për klasifikimin e rasteve kur viktima vuan prej disa dëmtimeve në pjesë të ndryshme të trupit dhe asnjëri prej këtyre dëmtimeve nuk është faktikisht më i rëndë se të tjerët. Kur në rastin e një aksidenti, i cili shkaktoi disa dëmtime në pjesë të ndryshme të trupit, njëri prej këtyre dëmtimeve është faktikisht më i rëndë se të tjerët, ky aksident duhet të klasifikohet në grupin që i korrespondon vendndodhjes së dëmtimit faktikisht më të rëndë. Për shembull, një frakturë e këmbës e shoqëruar me një gërvishtje të dorës, duhet të klasifikohet në grupin 54.

1. Koka

- 11 Pjesa e kafkës (kafka, truri, skalpi)
- 12 Syri (përfshirë nervin e gropës së syrit dhe atë optik)
- 13 Veshi
- 14 Goja (përfshirë buzët, dhëmbët dhe gjuhën)
- 15 Hunda
- 16 Fytyra, vendndodhjet e paklasifikuara gjetkë
- 18 Koka, vendndodhjet e shumfishta
- 19 Koka, vendndodhja e paspecifikuar

2. Qafa (përfshirë fytin dhe vertebrën cervikale)

3. Busti i trupit

- 31 Shpina (kollona kurrizore dhe muskujt kufizues, palca e kurrizit)
- 32 Gjoksi (brinjët, kërbishti, organet e brendëshme të gjoksit)
- 33 Barku (përfshirë organet e brendëshme)
- 34 Legeni
- 38 Busti, zonat e shumfishta
- 39 Busti, vendndodhja e paspecifikuar

4. Gjymtyrët e sipërme

- 41 Shpatulla (përfshirë klavikulën dhe trekëndëshin e shpatullës)

¹ Rezoluta lidhur me statistikat e dëmtimeve në punë. Konferenca e Dhjetë Ndërkombëtare e Staticjenëve të Punës, Gjenevë, 2-12 Tetor 1962.

- 42 Krahu i sipërm
 - 43 Brryli
 - 44 Parakrahu
 - 45 Kyçi
 - 46 Dora (me përjashtim vetëm të gishtërinjve)
 - 47 Gishtërinjtë
 - 48 Gjymtyrët e sipërme, zonat e shumfishta
 - 49 Gjymtyrët e sipërme, zona e paspecifikuar
5. Gjymtyrët e poshtme
- 51 Këllqet
 - 52 Kofsha (këmba e sipërme)
 - 53 Gjuri
 - 54 Këmba (këmba e poshtme)
 - 55 Nyja e këmbës
 - 56 Këmba (me përjashtim vetëm të gishtave të këmbës)
 - 57 Gishtat e këmbës
 - 58 Gjymtyrët e poshtme, vendndodhjet e shumfishta
 - 59 Gjymtyrët e poshtme, vendndodhja e paspecifikuar
6. Vendndodhjet e shumfishta
- 61 Koka dhe tringu, koka dhe një ose më shumë gjymtyrë
 - 62 Tringu dhe një ose më shumë gjymtyrë
 - 63 Një gjymtyrë e sipërme dhe një gjymtyrë e poshtme, ose më shumë se dy gjymtyrë
 - 68 Vendndodhjet e tjera të shumfishta
 - 69 Vendndodhjet e shumfishta, të pa specifikuara
7. Dëmtimet e përgjithshme
- 71 Sistemi qarkullues në përgjithsi
 - 72 Sistemi i frymëmarrjes në përgjithsi
 - 73 Sistemi i tretjes në përgjithsi
 - 74 Sistemi nervor në përgjithsi
 - 78 Dëmtimet e tjera të përgjithshme
 - 79 Dëmtimet e përgjithshme, të pa specifikuara

Ky grup do të përdoret vetëm në rastin kur funksionimi i sistemit aktiv të trupit është prekur pa ndonjë dëmtim specifik (për shembull, helmimi, etj.); kur dëmi sistematik rezulton nga një dëmtim që prek një pjesë specifike të trupit (për shembull, një frakturë e kollonës kurrizore që shkakton dëmtimin e palcës kurrizore), vendndodhja e dëmtimit në këtë pjesë të trupit (në këtë rast – kollona kurrizore) duhet të kodohet.

9. Vendndodhja e paspecifikuar e dëmtimit

Ky grup duhet të përdoret vetëm kur nuk ka informacion në dispozicion për identifikimin e pjesës së prekur të trupit.

Shënim: Klasifikimi i propozuar kufizohet tek sistemi dy shifror. Duke shtuar një shifër të tretë, shtetet që dëshirojnë të specifikojnë vendndodhjen e dëmtimit sipas anës së trupit ku ajo ka ndodhur, mund ta bëjnë atë kështu: (1) ana e djathtë; (2) ana e majtë; (3) të dyja anët. Për shembull, një frakturë e krahut të djathtë është klasifikuar në numrin 42(1), një ndrydhje e nyjes së këmbës së majtë, në 55(2), dhe një djegie e të dy syve në 12(3). Sidoqoftë, në rast se nuk është përdorur një shifër shtesë, dëmtimet tek të dy kyçet, ose tek të dy këmbët, etj., *nuk* duhen të klasifikohen në grupin 6 (vendndodhja shumëfishe), por vetëm në numrin korrespondues për një dëmtim në njërin nga kyçet (45), ose në njërin nga këmbët (56), etj.

Shtojca H: Klasifikimi i aksidenteve industriale sipas tipit të aksidentit¹

Ky klasifikim identifikon tipin e ngjarjes, e cila në mënyrë të drejtëpërdrejtë rezultoi në një dëmtim, dmth mënyrën nëpërmjet së cilës objekti apo substanca që shkakton dëmtimin, hyn në kontakt me personin e dëmtuar.

1. Rrëzimi i personave
 - 11 Rrëzimi i personave nga lartësitë (pemët, ndërtesat, skelat, shkallët, makinat, mjetet e transportit) dhe në thellësi (puset, hendekët, gërmimet, vrimat në tokë)
 - 12 Rrëzimi i personave në të njëjtin nivel
2. Goditja nga objektet në rënie
 - 21 Rrëshqitjet dhe epjet (toka, shkëmbinjtë, gurët, dëbora)
 - 22 Rrëzimi (ndërtesat, muret, skelat, shkallët, stivat me mallra)
 - 23 Goditja prej objekteve në rënie gjatë mbartjes
 - 24 Goditja prej objekteve në rënie, të paklasifikuara gjatë
3. Shkelja, përplasia dhe goditja prej objekteve, duke përjashtuar objektet në rënie
 - 31 Shkelja e objekteve
 - 32 Përplasia me objekte të palëvizshme (me përjashtim të pasojave për shkak të një rënie të mëparëshme)
 - 33 Përplasia me objekte në lëvizje
 - 34 Goditja prej objekteve në lëvizje (duke përfshirë elementët dhe pjesëzat fluturuese), duke përjashtuar objektet në rënie
4. Mbërthimi prej një objekti ose midis objekteve
 - 41 I mbërthyer prej një objekti
 - 42 I mbërthyer midis një objekti të palëvizshëm dhe një objekti të lëvizshëm
 - 43 I mbërthyer midis objekteve që lëvizin (me përjashtim të objekteve që fluturojnë apo bien)
5. Stërmundimi ose lëvizjet e mundimshme
 - 51 Stërmundimi në ngritje objektësh
 - 52 Stërmundimi në shtyrje apo tërheqje objektësh
 - 53 Stërmundimi në mbajtjen apo hedhjen e objekteve
 - 54 Lëvizjet e mundimshme

¹ Rezoluta lidhur me Statistikat e dëmtimeve në punë. Konferenca e Dhjetë Ndërkombëtare e Statisticjenëve të Punës, Gjenevë, 2-12 Tetor 1962.

6. Ekspozimi ndaj temperaturave ekstreme ose kontakti me to
 - 61 Ekspozimi ndaj nxehtësisë (atmosferae ose mjedisore)
 - 62 Ekspozimi ndaj të ftohtit (atmosferae ose mjedisore)
 - 63 Kontakti me substancat ose objektet e nxehta
 - 64 Kontakti me substancat ose objektet shumë të ftohta

7. Ekspozimi ndaj korrentit elektrik ose kontakti me të

8. Ekspozimi ndaj substancave apo rrezatimeve të dëmshme, ose kontakti me to
 - 81 Kontakti nëpërmjet thithjes, marrjes me ushqim dhe përvetsimit të substancave të dëmshme
 - 82 Ekspozimi ndaj rrezatimeve jonizuese
 - 83 Ekspozimi ndaj rrezatimeve, veç rrezatimeve jonizuese

9. Tipa të tjerë të aksidentit, të paklasifikuara gjetkë, duke përfshirë aksidentet e paklasifikuara si pasojë e mungesës së të dhënave të mjaftueshme
 - 91 Tipat e tjerë të aksidentit, të paklasifikuara gjetkë
 - 92 Aksidentet e paklasifikuara si pasojë e mungesës së të dhënave të mjaftueshme

Shtojca I: Klasifikimi i aksidenteve industriale sipas mjetit¹

Ky klasifikim mund të përdoret për të klasifikuar mjetin që ka lidhje ose me dëmtimin, ose me aksidentin:

- (a) kur klasifikimi është përdorur për të klasifikuar mjetin që ka lidhje me dëmtimin, pikat e zgjedhura për t'u koduar do të jenë ato që shkaktuan në mënyrë të drejtpërdrejtë dëmtimin, pa mbajtur në konsideratë ndikimin e tyre në fillimin e ngjarjes që është përcaktuar si tipi i aksidentit (shih Shtojcën H);
- (b) kur klasifikimi është përdorur për të klasifikuar mjetin që ka lidhje me aksidentin, pikat e zgjedhura për t'u koduar do të jenë ato të cilat, për arsye të natyrës ose kondicionit të tyre të rrezikshëm, përshpejtuan ngjarjen e përcaktuar si tipi i aksidentit (shih Shtojcën H).

1. Makinat

- 11 Motorrët e parë, me përjashtim të motorëve elektrikë
 - 111 Motorrët me avull
 - 112 Motorrët me djegie të brendëshme
 - 113 Të tjerat
- 12 Makineritë me transmision
 - 121 Boshtet transmetues
 - 122 Rrypat transmetues, kabllot, makaratë, rrotat e dhëmbëzuara, zinxhirët, rrotat e dhëmbëzuara të shpejtësisë
 - 129 Të tjerat
- 13 Makinat metalpunuese
 - 131 Presat me motor
 - 132 Tornot
 - 133 Frezat
 - 134 Gurët rektifikues
 - 135 Dykëmbëshat mekanikë të montimit
 - 136 Makinat farkëtuese
 - 137 Mullinjtë me rrule
 - 139 Të tjerat
- 14 Makinat për përpunimin e drurit
 - 141 Sharrat disk

¹ Rezoluta lidhur me statistikat e dëmtimeve në punë. Konferenca e Dhjetë Ndërkombëtare e Staticjenëve të Punës, Gjenevë, 2-12 Tetor 1962.

- 142 Sharrat e tjera
- 143 Makinat e derdhjes
- 144 Makina e zdrukthimit
- 149 Të tjerat

- 15 Makinat bujqësore
 - 151 Makinat korrëse (duke përfshirë kombajnat)
 - 152 Makinat shirëse
 - 159 Të tjerat

- 16 Makineritë e minjerave
 - 161 Makinat prerëse të nëndheshme
 - 169 Të tjerat

- 19 Makinat e tjera të paklasifikuara gjetkë
 - 191 Makinat e lëvizjes së dheut, makinat gërryese dhe copëtuese, me përjashtim të mjeteve të transportit
 - 192 Makinat tekstile tjerrëse, thurëse, etj
 - 193 Makinat për prodhimin e ushqimeve dhe pijeve
 - 194 Makinat për prodhimin e letrës
 - 195 Makinat e shtypshkrimit
 - 199 Të tjerat

2. Mjetet e transportit dhe paisjet ngritëse

- 21 Makinat dhe paisjet ngritëse
 - 211 Vinçat
 - 212 Ashensorët dhe ngritësit
 - 213 Çikrikët
 - 214 Parangot
 - 219 Të tjerat

- 22 Mjetet e transportit me binarë
 - 221 Hekurudhat ndër-qytetëse
 - 222 Transporti me binarë në minjera, tunele, gurore, ndërmarrje industriale, kantiere, etj.
 - 229 Të tjerat

- 23 Mjetet e tjera të transportit me rrota, duke përjashtuar transportin me binarë
 - 231 Traktorët
 - 232 Kamionët
 - 233 Kamionçinat
 - 234 Mjetet me motorr, të paklasifikuara gjetkë
 - 235 Mjetet e ngara nga kafshët
 - 236 Mjetet e ngara me dorë

- 239 Të tjerat
- 24 Mjetet e transportit ajror
- 25 Mjetet e transportit ujor
 - 251 Mjetet e motorizuara të transportit ujor
 - 252 Mjetet e pa-motorizuara të transportit ujor
- 26 Mjetet e tjera të transportit
 - 261 Vagonat me kavo
 - 262 Konvejerët mekanikë, me përjashtim të vagonave me kavo
 - 269 Të tjerat
- 3. Paisjet e tjera
 - 31 Rezervuarët e presionit
 - 311 Kaldajat
 - 312 Depozitat e presuara
 - 313 Sistemet e tubave dhe aksesoret e presuar
 - 314 Cilindrat e gazit
 - 315 Kasonet, pajisjet e zhytjes
 - 319 Të tjerat
 - 32 Furrat e shkrirjes, furrat, furrat e tharjes
 - 321 Furnaltat
 - 322 Furnaltat përpunuese
 - 323 Furrat e tjera
 - 324 Furrat e tharjes
 - 325 Furrat
 - 33 Paisjet ftohëse
 - 34 Instalimet ftohëse, duke përfshirë motorrët elektrikë, por duke përjashtuar veglat elektrike të dorës
 - 341 Makinat rrotulluese
 - 342 Përcjellësit
 - 343 Transformatorët
 - 344 Aparaturat e kontrollit
 - 349 Të tjerat
 - 35 Veglat elektrike të dorës
 - 36 Veglat, instrumentat dhe paisjet, me përjashtim të veglave elektrike të dorës

- 361 Veglat e dorës që vihen në punë me anë të energjisë, me përjashtim të veglave elektrike të dorës
- 362 Veglat e dorës, që nuk lëvizin me anë të energjisë
- 369 Të tjerat

- 37 Shkallët, platforma e lëvizëshme
- 38 Skela
- 39 Paisjet e tjera, të paklasifikuara gjetkë

4. Materialet, substancat dhe rrezatimet

- 41 Eksplozivët
- 42 Pluhurat, gazrat, lëngjet dhe kimikatet, duke përjashtuar eksplozivët
 - 421 Pluhurat
 - 422 Gazrat, avujt, tymrat
 - 423 Lëngjet e paklasifikuara gjetkë
 - 424 Kimikatet e paklasifikuara gjetkë
 - 429 Të tjerat
- 43 Elementët fluturues
- 44 Rrezatimet
 - 441 Rrezatimet jonizues
 - 449 Të tjerat
- 49 Materialet dhe substancat e tjera të paklasifikuara gjetkë

5. Mjedisi i punës

- 51 Jashtë derës
 - 511 Moti
 - 512 Trafiku dhe sipërfaqet ku punohet
 - 513 Uji
 - 519 Të tjerat
- 52 Brenda derës
 - 521 Dyshemetë
 - 522 Vendet e ngushta
 - 523 Shkallët
 - 524 Sipërfaqet e tjera të lëvizjes dhe punës
 - 525 Të çarat e dyshemesë dhe të murit
 - 526 Faktorët mjedisorë (ndriçimi, ajrimi, temperatura, zhurma, etj.)

- 529 Të tjerat
- 53 Në nëntokë
 - 531 Tavanet dhe faqet anësore të rrugëve dhe tuneleve të minjerave, etj.
 - 532 Dyshemetë e rrugëve dhe tuneleve të minjerave, etj.
 - 533 Faqet anësore punuese të minjerave, tuneleve, etj.
 - 534 Puset e minjerave
 - 535 Zjarri
 - 536 Uji
 - 539 Të tjerat
- 6. Mjetet e tjera, të paklasifikuara gjetkë
 - 61 Bagëtitë
 - 611 Bagëtitë e gjalla
 - 612 Produktet e bagëtive
 - 69 Mjetet e tjera, të paklasifikuara gjetkë
- 7. Mjetet e paklasifikuara për mungesë të të dhënave të mjaftueshme